

BALLAFAQIMI ME DEZINFORMATAT NË RRJETET SOCIALE

SFIDAT DHE PERSPEKTIVAT

iM@

PUBLIKIM ELEKTRONIK:

BALLAFAQIMI ME DEZINFORMATAT NË RRJETET SOCIALE - SFIDAT DHE PERSPEKTIVAT

(ANALIZA)

PUBLIKIM ELEKTRONIK: "BALLAFAQIMI ME DEZINFORMATAT NË RRJETET SOCIALE - SFIDAT DHE PERSPEKTIVAT (ANALIZA)"

Botues:

Instituti për Media dhe Analitikë IMA Shkup

Redaktor:

Petrit Saraçini

Autorë:

Dr. Snezhana Trpevska

Svetllana Siljanoska

Mr. Filip Stojanovski

Përkthimi:

Riza Imeri

Dizajni:

Jane Stefanov

Shkup, shkurt 2025

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen e Fondit Evropian për Demokraci (FED) - European Endowment for Democracy (EED). Përmbajtja e tij nuk pasqyron domosdoshmërisht opinionin zyrtar të EED. Përgjegjësia për informacionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë publikim i takon tërësisht autorit(ëve).

PËRMBAJTJA

HYRJE 5

Dr. SNEZHANA TRPEVSKA
ROLI I ‘SHËNJUESVE TË BESUAR› PËR MBROJTJEN NGA DEZINFORMATAT DHE PËRMBAJTJET E TJERA TË DËMSHME NË RRJETET SOCIALE 7

SVETLLANA SILJANOVSKA
DISTOPIA DIGJITALE DEMOKRATIKE DHE DALJA PREJ SAJ 19

FILIP STOJANOVSKI
BALLAFAQIMI ME DEZINFORMATAT NË RRJETET SOCIALE: PSE ËSHTË I NEVOJSHËM VERIFIKIMI I FAKTEVE? 37

HYRJE

Publikimi “Ballafaqimi me dezinformatat në rrjetet sociale – sfidat dhe perspektivat (analiza)” sjell analiza autoriale nga dr. Snezhana Trpevska nga Instituti RESIS, Svetllana Siljanoska – konsulente për komunikime strategjike dhe ballafaqim me dezinformata, dhe Filip Stojanovski nga Fondacioni Metamorfozis. Autorët kanë përvojë shumëvjeçare në zbatimin e projekteve, hulumtimeve dhe analizave në fushën e mediave dhe komunikimit publik, një pjesë e të cilave kanë të bëjnë me ballafaqimin me dezinformatat dhe llojet e tjera të përmbajtjeve të dëmshme në rrjetet sociale dhe në media.

Përfundim i përbashkët i analizave në këtë publikim është se rrjetet sociale përdoren si kanal kryesor për shpërndarje të dezinformatave, përmbajtjeve manipuluese dhe të dëmshme, të cilat kanë pasoja serioze për shoqëritë demokratike dhe të drejtat e njeriut, si dhe për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse, përfshirë proceset zgjedhore. Analizat trajtojnë disa aspekte të rëndësishme, duke përfshirë legjislacionin evropian dhe nacional si dhe mekanizmat për parandalimin e përhapjes së dezinformatave dhe përmbajtjeve të dëmshme në onlajn platformat e mëdha, shembuj të ndikimit të tyre dhe mënyrave të trajtimit në më shumë vende, si dhe rolin e shënjuesve të besuar dhe verifikimit të fakteve në ballafaqimin më këto fenomene.

Analizat gjithashtu japin rekomandime për zgjidhje dhe veprime që mund të ndërmerren nga institucionet, sistemi arsimor, organizatat mediatike dhe të shoqërisë civile, si dhe nga aktorë të tjerë në shoqëri, që do të kontribuonin për ballafaqim më të mirë me këto sfida, duke theksuar nevojën për një qasje të përbashkët dhe të koordinuar nga e gjithë shoqëria dhe të gjitha palët e interesuara.

Publikimi është pjesë e aktiviteteve të Institutit për Media dhe Analitikë IMA, të mbështetura nga Fondi Evropian për Demokraci (European Endowment for Democracy) nga Brukseli, dhe është një kontribut në realizimin e angazhimeve të IMA-s për avancimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut, përmes bashkëpunimit me institucionet, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat për përballje me dëmet nga polarizimi, gjuha e urrejtjes, dezinformatat dhe sulmet ndaj mendimtarëve kritikë në media dhe në komunikimin publik.

Instituti për Media dhe Analitikë IMA Shkup

1. ROLI I 'SHËNJUESVE TË BESUAR› PËR MBROJTJEN NGA DEZINFORMATAT DHE PËRMBAJTJET E TJERA TË DËMSHME NË RRJETET SOCIALE

Shkruan: Dr. SNEZHANA TRPEVSKA

Me paketën e rregullativave të Bashkimit Evropian që hyrën në fuqi në vitet 2023 dhe 2024, për onlajn platformat që kanë numër të madh përdoruesish parashihen rregulla shumë të rrepta që kanë për qëllim mbrojtjen e përdoruesve dhe shoqërisë në tërësi nga pasojat e shumta negative. Një nga çështjet që shkakton brengosje të veçantë është mundësia e përhapjes së dezinformatave, misinformatave dhe llojeve të tjera të përmbajtjeve manipuluese dhe të dëmshme përmes rrjeteve të mëdha sociale.

Për këtë çështje është kyçe Rregullativa e shërbimeve digjitale, por e rëndësishme është edhe Direktiva për shërbimet mediatike audiovizuale e vitit 2018, me të cilën legjislacioni ynë u përafrua në qershor të vitit 2023.

Rolin parësor në mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre rregullativave e kanë shtetet anëtare të BE-së, me mbështetjen e Bordit Evropian për Shërbime Digjitale. Për platformat më të mëdha, mbikëqyrja dhe zbatimi i rregullave do të kryhen nga Komisioni Evropian, bashkërisht me rregullatorin e shtetit - anëtar të BE-së në të cilin është selia e platformës. 13 nga gjithsej 22 platforma dhe motorë kërkues shumë të mëdhenj, përfshirë TikTok-un, e kanë selinë e tyre evropiane në Irlandë.

Sigurisht që këto rregullativa do të duhet të zbatohen gradualisht edhe në vendet kandidate për anëtarësim në BE, por ky është një proces me shumë pyetje dhe dilema të hapura edhe për vendet anëtare të BE-së që janë shumë më përpara në rregullimin e hapësirës onlajn. Vendin tonë në të ardhmen e pret punë për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me këto rregullativa të reja. Ky proces pritej të fillonte në vitin 2023, kur një ekip i pavarur ekspertësh përgatiti analiza dhe bëri një sërë rekomandimesh dhe propozimesh për ndryshime në ligjet për media dhe ligje të tjera. Megjithatë, ndryshimet nga korriku i vitit 2023 u kufizuan vetëm në harmonizimin e vonuar me Direktivën për shërbimeve mediatike audiovizuale të vitit 2018.

Çfarë përmban paketa rregullatore e BE-së për shërbimet digjitale?

Bashkimi Evropian ka zhvilluar një qasje gjithëpërfshirëse rregullatore për çështjet komplekse që lidhen me përfitimet shoqërore të zhvillimit digjital, por edhe për zgjidhjen e një sërë të pasojave që i sjellin teknologjitë digjitale dhe interneti për shoqëritë evropiane. Në qasjen strategjike të titulluar "Një Evropë e përshtatshme për epokën digjitale"[1], Komisioni Evropian përcolli qartë mesazhin se "Evropa duhet të forcojë sovranitetin e saj digjital dhe të vendosë standarde, në vend që të ndjekë standardet e të tjerëve - me një fokus të qartë në të dhënat, teknologjinë dhe infrastrukturën". Në paketën e rregullativave që dolën nga strategjia e zhvillimit digjital të BE-së, kyçe janë Rregullativa e shërbimeve digjitale (RSHD)[2], e cila filloi të zbatohej në platformat e mëdha që në gusht të vitit 2023, dhe Rregullativa për tregjet digjitale (RTD)[3].

Me këto dy rregullativa u inkuadruan rregulla për lloje të ndryshme shërbimesh digjitale, duke përfshirë: motorët e kërkimit, uebfaqet, onlajn platforma në të cilat shpërndahen përmbajtje, onlajn platforma përmes të cilave blihen produkte, onlajn shitore për softuerë dhe aplikacione, platformat përmes të cilave mund të rezervohen dhe blihen udhëtime, dhe një sërë e llojeve të tjera të shërbimeve.

Bëhet fjalë për shërbime që kanë një ndikim të madh në jetën tonë, sepse gjithçka është tashmë e digjitalizuar, ndryshuan mënyrat se si punojmë, blejmë, edukohemi, informohemi, argëtohemi dhe, gjë që është veçanërisht e rëndësishme - angazhohemi në sferën publike për të ndikuar në proceset politike dhe shoqërore. Përfitimet nga këto shërbime janë shumë pozitive, pasi ato lehtësojnë tregtinë ndërkufitare, hapin mundësi për sipërmarrje të reja biznesi dhe qasje në tregje të reja, gjë që stimulon zhvillimin ekonomik. Por, në të njëjtën kohë, ato mund të kenë edhe pasoja të shumta negative në ekonomi dhe shoqërinë në tërësi. Për shembull, përveç mundësive për tregtimin e mallrave dhe shërbimeve jolegale, ekziston shqetësim i madh për keqpërdorimin manipulues të sistemeve algoritmike me qëllim të përhapjes së propagandës, dezinformatave ose përmbajtjeve të tjera të dëmshme.

Veçanërisht brengos ajo se me digjitalizimin e shoqërisë dhe ekonomisë u krijua situatë, në të cilën disa platforma (private) të mëdha kontrollojnë ekosisteme të rëndësishme në ekonominë digjitale dhe luajnë rolin e "gatekeepers" (rojtarë të portave) që diktojnë kushtet e tregjeve digjitale, duke imponuar rregullat e tyre. Këto rregulla, nga ana tjetër, krijojnë kushte të padrejta për bizneset që përdorin platformat dhe lënë pak zgjedhje për përdoruesit ose konsumatorët. Dy rregullativat kyçe të Bashkimit Evropian u miratuan pikërisht për të adresuar këto sfida, duke forcuar onlajn sigurinë e përdoruesve, duke mbrojtur të drejtat e tyre themelore dhe duke krijuar punë fer dhe transparente të bizneseve në platformat onlajn.

Të dyja rregullativat përmbajnë një sërë rregullash që plotësojnë njëra-tjetrën:

(1) Rregullat e përcaktuara në Rregullativën e shërbimeve digjitale (RSHD) u referohen kryesisht onlajn ndërmjetësuesve dhe platformave: onlajn tregjeve, rrjeteve sociale, platformave për shpërndarje të përmbajtjes, shitoreve për aplikacione dhe onlajn platformave për udhëtim.

(2) Rregullativa për tregjet digjitale (RTD) inkuadron rregulla me të cilat rregullohet sjellja "gatekeeper" platformave që veprojnë si ngushtica midis bizneseve dhe konsumatorëve të shërbimeve të rëndësishme digjitale. Disa nga këto platforma rregullohen edhe nga Rregullativa për shërbime digjitale, por qëllimi dhe rregullat atje janë të ndryshme.

Shënjuesit e besuar në Rregullativën për shërbime digjitale

Një nga qëllimet kryesore të Rregullativës për shërbime digjitale është të parandalojë aktivitetet jolegale dhe të dëmshme në internet dhe të merret me përhapjen e dezinformatave. Ka një sërë detyrimesh të cilave duhet t'u përmbahen platformat e mëdha onlajn për të përmbushur këto synime. Një detyrim i tillë është që të veprohet shpejt kur njoftohet nga të ashtuquajturit "shënjues të besuar" për përmbajtje jolegale të botuar në platformën e tyre.

Kreu III i Rregullativës për shërbimeve digjitale titullohet "Detyrime të kujdesit të duhur për mjedis transparent, të qasshëm dhe të sigurt onlajn". Neni 19 i këtij kapitulli përcakton detyrimet e shënjuesve të besuar në kontekstin e mekanizmave të «njoftimit dhe veprimit" për përmbajtje jolegale që duhet të inkuadrohen detyrimisht nga platformat e mëdha onlajn. Kjo do të thotë se platformat e mëdha janë të detyruara inkuadrojnë mekanizëm, përmes të cilit vetë përdoruesit mund të shënjojnë një përmbajtje të caktuar si jolegale dhe të bashkëpunojnë me të ashtuquajturit shënjues të besuar, organizata të jashtme që janë të autorizuara për këtë dhe që duhet të plotësojnë disa kushte të caktuara në nenin 19 të RSHD.

Cilat kushte kumulative duhet t'i plotësojnë shënjuesit e besuar:

(1) të posedojnë ekspertizë specifike dhe kompetenca për zbulim, identifikim dhe raportim të përmbajtjeve jolegale dhe të kenë qenë aktivë më parë në zbatimin e aktiviteteve në atë fushë;

(2) të përfaqësojnë interesat kolektive dhe të jenë të pavarur nga cilado qoftë onlajn platformë;

(3) të kryejnë veprimin në mënyrë që siguron raportim të saktë dhe objektiv të përmbajtjes jolegale;

(4) të kenë burime transparente të financimit; dhe

(5) të paktën një herë në vit të paraqesin raport për aktivitetet e tyre dhe njoftimet për të cilat kanë vepruar në vitin paraprak.

Lloje të ndryshme organizatash mund të autorizohen për të mbikëqyrur përmbajtjen e onlajn platformave: organe publike të autorizuara, organizata joqeveritare, organizata të konsumatorëve, rrjete vetërregulluese, organizata për mbrojtjen e të drejtave të autorësisë dhe subjekte të tjera, në varësi prej sferës së mbikëqyrjes.

Që të bëhet ndonjë organizatë shënjues i besuar, duhet të aplikojë dhe të ofrojë prova se i plotëson të gjitha kërkesat kumulative. Statusi "shënjues i besuar" jepet nga *Koordinatori i shërbimeve digjitale* që duhet të emërohet me ligj në çdo shtet - anëtar të BE-së dhe jepet për një periudhë 2-vjeçare, me mundësi të ripërtëritjes. Lista e shënjuesve të besuar në vendet do të publikohet dhe përditësohet rregullisht nga Komisioni Evropian, në një bazë të të dhënave të disponueshme publikisht. Ky status mund të humbet, nëse Koordinatori i shërbimeve digjitale vendos se organizata nuk i plotëson më kërkesat.

Platformat onlajn kanë detyrim t'u japin përparësi dhe të përpunojnë shpejt njoftimet e marra nga shënjuesit e besuar. Përveç kësaj, ata duhet të publikojnë në raportet e tyre vjetore numrin e raportimeve të marra nga shënjuesit e besuar dhe veprimet e ndërmarra në lidhje me ato njoftime. Ajo që është e rëndësishme është se koha e përpunimit të njoftimeve mund të ndryshojë në varësi nga lloji i përmbajtjes jolegale, cilësia e njoftimit, si dhe procedurave teknike për dërgimin e njoftimit. Megjithatë, sa i përket mënjanimit të përmbajtjeve me gjuhë të urrejtjes që janë të përcaktuara si përmbajtje jolegale me ligj, koha e nevojshme për të përpunuar shumicën e njoftimeve të vlefshme është 24 orë.

Si u zhvillua zbatimi i RSHD gjatë vitit 2024?

Duke parashikuar kërcënimin nga përhapja e dezinformatave para zgjedhjeve evropiane të qershorit 2024, Komisioni Evropian ndërmori një sërë masash për të zbutur rreziqet sistemore që mund të ndikonin në integritetin e zgjedhjeve· RSHD hyri në fuqi tërësisht më 17 shkurt 2024, ndaj ishte shumë e rëndësishme që zbatimi efektiv dhe i shpejtë i saj të fillonte menjëherë. Një nga synimet kryesore të RSHD është pikërisht zbutja e rrezikut nga dezinformatat gjatë zgjedhjeve, kështu që Komisioni në muajt e parë e plotësoi Rregullativën me udhëzime, mjete për raportim, madje filloi edhe me masa për zbatimin e saj·

Më 26 prill 2024, Komisioni botoi dokumentin me Udhëzime[4], ku rekomandoi një sërë masash dhe praktikash, të cilat duhet t'i ndërmarrin rrjetet e mëdha dhe motorët e kërkimit para, gjatë dhe pas ngjarjeve zgjedhore: (1) promovim i informacioneve zyrtare rreth proceseve zgjedhore, inkuadrim i aktiviteteve për edukim mediatik të përdoruesve, përshtatje të sistemeve të rekomandimeve dhe reduktim të monetizimit dhe viralitetit të përmbajtjeve që rrezikojnë integritetin e proceseve zgjedhore; (2) inkuadrim të masave specifike në lidhje me IA gjeneruese, për shembull shënjim i qartë dhe sigurim i autenticitetit të përmbajtjes së IA; (3) bashkëpunim me autoritetet dhe organizatat e tjera në shkëmbimin efikas të informacionit para, gjatë dhe pas zgjedhjeve; (4) reduktim të ndikimit të incidenteve që mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në rezultatin e zgjedhjeve ose pjesëmarrjen; dhe (5) vlerësim të efektivitetit të masave të ndërmarra pas zgjedhjeve.

Disa efekte pozitive mund të shiheshin menjëherë pas hapave të ndërmarrë nga Komisioni Evropian. Për shembull, Google paralajmëroi se do të edukojë përdoruesit e tij se si të identifikojnë dhe të shmangin dezinformatat përmes një serie reklamash prej 50 sekondash që do të botohen para zgjedhjeve në pesë vende evropiane. Në një intervistë për Time[5], të botuar më 25 prill 2024, Beth Goldberg, drejtuese e hulumtimeve në njësinë e brendshme të Google Jigsaw, shpjegoi më hollësisht se fushata e Google është përpjekje për të ndihmuar votuesit të njohin praktikën manipuluese të njohur si "dekontekstualizim", në të cilën një fakt ose deklaratë nxirret jashtë kontekstit origjinal dhe adekuat.

Mirëpo, Komisioni gjithashtu tregoi se është i vendosur të veprojë kur do të vërtetojë se masat dhe kërkesat e tij nuk respektohen. Më 30 prill 2024, filloi një procedurë zyrtare[6] për të vlerësuar nëse Meta, kompania që qëndron pas Facebook dhe Instagram, kishte shkelur detyrimet e saja sipas RSHD. Hetimi, ndër të tjera, kishte të bënte me dyshimet se Meta: nuk ka zbatuar masa për të parandaluar ose zbutur efektet e fushatave dezinformuese, nuk ka siguruar dukshmëri të përmbajtjeve politike dhe ka hequr mjetin "CrowdTangle", i cili u mundëson hulumtuesve, gazetarëve dhe shoqërisë civile të monitorojnë zgjedhjet në kohë reale.

Cilët janë koordinatorët për shërbime digjitale?

Menjëherë pas hyrjes në fuqi të RSHD, të gjitha vendet - anëtarë të BE kishin për detyrim të caktojnë koordinatorë për shërbime digjitale, të cilët do të ndihmojnë Komisionin Evropian në mbikëqyrjen dhe zbatimin e detyrimeve të Rregullativës. Emërimi i koordinatorëve nacionalë për shërbimet digjitale me kompetenca të plota ligjore është një parakusht kyç për zbatimin e RSHD, veçanërisht që përdoruesit të mund të parashtrojnë

në vendin e tyre raportime për përmbajtje jolegale në platformat dhe që të zbatohet procedura për dhënien e statusit të shënjuesve të besuar në vendin specifik.

Së bashku, koordinatorët për shërbime digjitale duhet të sigurojnë që RSHD të zbatohet në një mënyrë të harmonizuar në të gjitha vendet e BE. Ata bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, me autoritetet e tjera nacionale, me Bordin e shërbimeve digjitale dhe me Komisionin Evropian. Kompetencat e tyre kryesore janë: të kërkojnë qasje në të dhëna, të urdhërojnë inspektime dhe të kumtojnë dënime për ofruesit e shërbimeve ndërmjetësuese që janë të themeluar në territorin e tyre. Siç u përmend më herët, ata kanë kompetenca për certifikimin e «shënjuesve të besuar” dhe për organet përgjegjëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës.

Gjatë vitit 2024, Komisioni Evropian nisi disa procedura formale të njëpasnjëshme për shtetet - anëtare që nuk kishin caktuar ende koordinatorë digjital. Në fund të vitit 2024, nga gjithsej 27 vende - anëtarë, në 25 ishin emëruar koordinatorë digjitalë[7]. Në shumicën e vendeve, këtë status e kanë rregullatorët për komunikime, e në disa raste rregullatorët e mediave, rregullatorët për mbrojtjen e konkurrencës, për mbrojtjen e konsumatorëve ose për shërbimet e transportit dhe/ose shërbimet postare.

Komisioni i Medias i Irlandës është koordinator digjital që ka juridiksion mbi kompaninë Meta dhe mbi dhjetë motorë kërkimi platforma tjera të mëdha. Ai është organi i parë nacional që botoi Udhëzues[8] për atë se si mund të fitohet statusi i shënjuesit të besuar. Sipas këtij Udhëzuesi, anëtarët e rrjeteve tashmë të krijuara të shërbimeve për kontrollimin e fakteve (siç është shërbimi i kontrollit të fakteve të organizatës Metamorfozis në vendin tonë) gjithashtu mund të fitojnë statusin e një shënjuesi të besuar.

Numri i shënjuesve të besuar të certifikuar është ende i ulët!

Vetëm organizatat me seli në BE mund të aplikojnë për statusin e shënjuesit të besuar. Qëllimi është të sigurohet që këto organizata të punojnë sipas kornizës rregullatore të BE-së, gjegjësisht të sigurohet qasje e harmonizuar në ballafaqimin me përmbajtjet jolegale në internet. Kur një organizatë e fiton statusin e shënjuesit të besuar, atëherë certifikata e saj është e vlefshme në të gjithë Bashkimin Evropian edhe në raport me cilëndo qoftë platformë onlajn, pavarësisht nga vendi i themelimit.

Udhëzuesi i Komisionit irlandez të medias[9] përmban një listë me 60 fusha me përmbajtje jolegale të mbuluara nga RSHD, duke filluar nga shkeljet e të drejtave të kafshëve deri te gjuha e urrejtjes dhe shkeljet e të drejtave autoriale. Duke pasur parasysh këtë mori përmbajtjesh të ndryshme jolegale, ishte logjike të pritej se në listë do të ketë një numër të madh organizatash të pranueshme.

Megjithatë, pas pothuajse një viti të plotë nga hyrja në fuqi të RSHD, kjo listë përbëhet nga vetëm 16 organizata[10], ndërsa për asnjëra prej tyre nuk thuhet shprehimisht se ka ekspertizë dhe autorizim për të identifikuar dhe raportuar dezinformatat. Në përshkrimin e vetëm një organizate franceze (e-Enfance) thuhet se, përveç llojeve të tjera të përmbajtjes, ajo ndjek edhe përmbajtje që mund të kërcënojnë sigurinë publike. Disa organizata janë të autorizuara për përmbajtje të dëmshme për të miturit dhe për gjuhë të urrejtjes, disa për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe disa për mashtrim dhe tregti me produkte jolegale.

Kjo tregon se zbatimi i konceptit të "shënjuesve të besuar", veçanërisht në fushën e mbrojtjes nga dezinformatat, nuk po zhvillohet lehtë. Në përgjithësi, ideja për të pasur organizata kredibile që do të detektojnë dhe raportojnë dezinformata, gjuhë të urrejtjes ose përmbajtje të tjera të dëmshme është plotësisht e justifikuar, sepse kjo është një detyrë jashtëzakonisht komplekse dhe e përgjegjshme. Përdorimi i njohurive specifike dhe ekspertizës të ekipeve të hulumtuesve në një fushë të caktuar e rrit kredibilitetin e raporteve të paraqitura dhe e bën më efikase dhe më të suksesshme procedurën e identifikimit dhe mënjanimit të përmbajtjeve jolegale nga hapësira onlajn.

Në fakt, koncepti i shënjuesve të besuar nuk është i ri, me atë që ata janë përzgjedhur më parë nga vetë platformat. Për shembull, si YouTube ashtu edhe Google kanë programe ose organizata partnere për shënjim që janë të ngjashme me idenë e shënjuesve të besuar. Dallimi kryesor është se ato funksionojnë në baza vullnetare, sipas kushteve platformës që vendos vetë se cilat subjekte do t'i përcaktojë si shënjues të besuar. Sipas RSHD, kjo kompetencë i jepet Koordinatorit të shërbimeve digjitale, e angazhimi i tyre nuk është në bazë vullnetare.

Por, pse është ende e shkurtër lista e shënjuesve të besuar? Arsyet janë ndoshta disa: *së pari*, procedura për emërimin e koordinatorëve digjitalë u zhvillua në mënyrë të ngadaltë, e diku ende nuk janë emëruar ose nuk është definuar procedura për certifikimin e shënjuesve të besuar; *së dyti*, organizatat qytetare ose hulumtuese që kanë ekspertizë dhe proces të vendosur për paraqitjen e përmbajtjeve jolegale kanë resurse të kufizuara; *së treti*, nevojitet pavarësia nga platformat, por disa organizata joqeveritare që veçmë kanë sisteme monitorimi marrin mbështetje financiare nga platforma si Meta, TikTok, Google e të tjera; *së katërti*, mungesa e mbështetjes – megjithëse disa vende po zhvillojnë programe trajnimi për shënjues të besuar, prapëseprapë mungon mbështetja më e gjerë dhe stimulimet financiare.

A do t'i mbajë Meta shënjuesit e besuar në Evropë?

Në fillim të janarit të këtij viti, Mark Zuckerberg njoftoi se kompania e tij planifikon të ndërpresë shërbimin e kontrollit të fakteve, gjë që do të dobësojë edhe masat për parandalim të dezinformatave në Facebook, Instagram dhe Temu. Kjo u vlerësua si një përpjekje për të fituar favorin e Trump, por edhe si një synim për të rritur angazhimin e përdoruesve në të gjitha rrjetet sociale të Meta. Është fakt se përhapja e dezinformatave është një biznes fitimprurës për platformat onlajn. Sa më provokuese dhe më tronditëse janë përmbajtjet që shpërndahen nëpër platforma, aq më gjatë qëndrojnë përdoruesit në to. Përveç kësaj, «sistemet e rekomandimeve» të automatizuara dhe algoritmet e përdorura nga platformat ofrojnë më tepër përmbajtje të ngjashme me ato që përdoruesit kanë parë më parë.

Menjëherë pas njoftimit të Zuckerberg, u ngrit pyetja se si do të reagojë Komisioni Evropian ndaj këtij veprimi të Meta, nëse kjo ndodh edhe në Evropë. Vetë Zuckerberg nuk ishte mjaft i saktë për planet e Meta për Evropën – duke thënë se "nuk kanë plan kjo të ndodhë menjëherë", duke nënkuptuar detyrimet e RSHD. Dihet se Meta ka një rrjet të shërbimeve për kontrollim të fakteve në 130 vende, të cilat i financon vetë. Rrjeti u krijua pas zgjedhjeve të vitit 2016 në SHBA, për shkak të problemit të njohur me përhapjen e lajmeve të rreme në Facebook gjatë fushatës zgjedhore.

Është ende e pasigurt se çfarë do të ndodhë me verifikuesit e fakteve Meta në Evropë, megjithëse Komisioni Evropian ishte kategorik në qëllimin e tij për të siguruar zbatimin e RSHD, duke e treguar këtë veçanërisht me rastin e ngritur kundër "X" të Elon Musk, aktakuzë e parë formale e ngritur në bazë të RSHD[11], lidhur me joefektivitetin e masave të marra për të luftuar manipulimin me informacionet gjatë proceseve zgjedhore. Megjithatë, edhe pas një viti të zbatimit, po tregohet se RSHD nuk është e qartë mjaftueshëm dhe ka mangësi, veçanërisht në lidhje me mënyrën se si duhet të punojnë platformat me shënjuesit e besueshëm.

Deri më tani, komenti i vetëm i Komisionit Evropian për veprimin e Meta ishte se secila platformë e madhe do të duhet të "zbatojë një vlerësim rreziku dhe t'ia dërgojë Komisionit për shqyrtim, para se të ndërpresë lidhjet me shërbimet evropiane të kontrollit të fakteve". Atë që do të ndërmarrë Komisioni më pas do të jetë një test kyç i aplikimit të RSHD, e ndoshta do të ndikojë edhe në sjelljen e Meta në mbarë botën. Zëdhënësi i Komisionit Evropian theksoi se puna e kontrolluesve të pavarur të fakteve konsiderohet si një mënyrë efikase për reduktim të rreziqeve sistemore që rrjedhin nga shërbimet e platformave të mëdha onlajn, duke përfshirë në veçanti rreziqet nga dezinformatat gjatë proceseve zgjedhore.

Roli i rregullatorëve të medias në mbrojtjen kundër përmbajtjeve jolegale dhe dezinformatave në platformat onlajn

Siç u theksua në hyrje, përveç RSHD, për ballafaqimin me përmbajtjet jolegale dhe të dëmshme në hapësirën onlajn, është gjithashtu e rëndësishme Direktiva e BE për Shërbimet mediatike audiovizuale (DSHMA) e vitit 2018. RSHD në pjesën hyrëse përcakton disa lloje të përmbajtjeve jolegale: gjuha e urrejtjes dhe përmbajtjet diskriminuese, përmbajtjet përhapja e të cilave përbën një aktivitet të paligjshëm, duke përfshirë nxitjen publike për të kryer akte terroriste, akte që lidhen me pornografinë e fëmijëve dhe akte që lidhen me racizmin dhe ksenofobinë. Këto janë gjithashtu përmbajtje jolegale të ndaluara në platformat e shpërndarjes së videove (PSHV) me Direktivën për shërbimeve mediatike audiovizuale.

Përveç kësaj, të dyja rregullativat kërkojnë që platformat onlajn të kyçin "Termat dhe Kushtet" (T&K) për përdoruesit, të cilat duhet të përfshijnë masa për mbrojtje të të miturve dhe publikut të gjerë nga përmbajtjet jolegale dhe të dëmshme. Megjithatë, RSHD përcakton rregulla shumë më të hollësishme mbi atë që duhet të përmbajnë T&K, veçanërisht në lidhje me procedurën e ankesave dhe procedurat e moderimin e përmbajtjeve. Më tej, të dy dokumentet kërkojnë identifikimin e reklamimit, por RSHD edhe në lidhje me këtë çështje vendos detyrime më të rrepta dhe më të detajuara për platformat për: personin fizik dhe juridik në emër të të cilit kryhet reklamimi, ose që paguan për reklamimin.

"Shënjuesit e besueshëm" janë të rëndësishëm për aplikimin e DSHMA në drejtim të mbrojtjes nga të gjitha llojet e përmbajtjeve jolegale të shpërndara në platformat për shpërndarje të videove. Direktiva përmban më tepër masa që PNV duhet të marrin për këtë qëllim, duke përfshirë mekanizmat transparentë për raportimin dhe shënjimin e përmbajtjeve dhe procedurat efektive për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të përdoruesve. Direktiva specifikon gjithashtu se masat duhet të jenë të përshtatshme për llojin e përmbajtjes, dëmin e mundshëm, kategorinë e përdoruesve që duhet të mbrohen,

interesat dhe të drejtat legjitime, si dhe interesin publik që duhet mbrojtur. Rolin kyç në vlerësimin e përshtatshmërisë së masave duhet ta luajnë organet rregullatore të medias.

E gjithë kjo nënkupton se zbatimi i të dyja rregullativave, për të qenë efikas, duhet të bëhet paralelisht, përmes bashkëpunimit të organeve rregullatore të medias, duke pasur parasysh se vetëm organet rregullatore nacionale të vendeve ku janë themeluar kanë juridiksion mbi PNV-të e mëdha. Bashkëpunimi i organeve rregullatore zhvillohet si në mënyrë dypalëshe, ashtu edhe përmes punës së Grupit evropian të rregullatorëve për shërbimet mediatike audiovizuale (European Regulators Group for Audiovisual Media Services – ERGA). Në qershor 2021, Grupi i rregullatorëve evropianë publikoi një dokument në të cilin kumtoi qëndrimin e tij për lidhshmërinë midis dy rregullativave: "RSHD duhet të parashikojë në mënyrë eksplicite që rregullatorëve kombëtarë të caktuar si autoritete RSHD nga shtetet anëtare për platformat e shpërndarjes së videove, brenda kornizës së Direktivës së shërbimeve mediatike audiovizive, duhet t'u besohet, në nivel nacional, zbatimi i dhe aplikimi i rregullave të RSHD që lidhen me rregullimin e përmbajtjeve onlajn. Në të njëjtën mënyrë, RSHD duhet t'i referohet Grupit të rregullatorëve evropianë dhe ta autorizojë atë për të mbështetur/siguruar zbatimin ndërkufitar të RSHD në lidhje me rregullimin e përmbajtjeve onlajn."

Komisioni Evropian bashkëpunon intensivisht me Grupin e rregullatorëve evropianë në zbatimin e RSHD. Në fushën e mbrojtjes nga dezinformatat, në maj të vitit 2024, në prag të zgjedhjeve evropiane, Komisioni, së bashku me Grupin e rregullatorëve evropianë, zhvilluan një fushatë për ndërgjegjësimin për rreziqet e nga dezinformatat dhe manipulimi me informacionet nga burime të huaja.[12] Për më tepër, Grupi i rregullatorëve evropianë është anëtar aktiv i Grupit të përhershëm të punës për zbatimin e Kodit të Praktikave mbi dezinformatat, i cili u transformua në Kod të Sjelljes sipas dispozitave të RSHD. Me miratimin e Rregullativës për lirinë e medias (European Media Freedom Act – EMFA), Grupi i rregullatorëve evropianë do të vazhdojë të funksionojë në të ardhmen si Bord evropian për shërbime mediatike (European Board for Media Services – EBMS).

Korniza bashkëpunuese e vendosur ndërmjet Komisionit Evropian, Bordit evropian të shërbimeve digjitale dhe Grupit të rregullatorëve evropianë synon të sigurojë që platformat dhe motorët e kërkimit onlajn do të përmbushin detyrimet e tyre për reduktim të dezinformatave në hapësirën digjitale evropiane. Në dhjetor të vitit 2024, Grupi i rregullatorëve evropianë ka shpallur qëndrimin e tij se "platformat duhet të investojnë më shumë resurse në nivel kombëtar...Kjo përfshin rritjen e mbështetjes për organizatat për kontrollim të fakteve dhe nismave për edukim mediatik..."[13].

Ku është Maqedonia në harmonizimin me pakon e rregullativave të BE-së?

Nga shtatori 2022 deri në dhjetor të vitit 2023, në kuadër të projektit të mbështetur nga Komisioni Evropian[14], në vend nisi procesi i shumëpritur i reformimit të legjislacionit mediatik. Qëllimi i projektit ishte të analizojë situatën në të gjithë ekosistemin e medias dhe të ofrojë propozime dhe udhëzime konkrete për përfshirjen e rregullativave dhe rekomandimeve evropiane, duke përfshirë Rregullativën e Shërbimeve Digjitale të miratuar së fundmi, si dhe Rregullativën e paralajmëruar për lirinë e medias. Procesi u koordinua nga Ministria e atëhershme e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA), me mbështetjen eksperte të një ekipi ekspertësh ndërkombëtarë dhe vendas të mediave të angazhuar në kuadër të projektit.

Sipas planit të parashikuar fillimisht, të gjitha analizat dhe hulumtimet duhej të përfundonin në disa muajt e parë, që më pas, në gjysmën e dytë të vitit të projektit, të hartoheshin propozime për ligje të reja dhe të zbatohej një proces i gjerë konsultimi publik me të gjitha palët e interesuara. Në fund të procesit, ministria kompetente, organi rregullator dhe institucionet dhe organizatat e tjera do të fitonin një sërë analizash dhe dokumentesh që do të përbënin kornizën e re strategjike për zhvillimin e sektorit të medias, si dhe propozime të hartuara konkrete për ligje të reja dhe masa e aktivitete të tjera.

Për shkak të vonesës në harmonizimin me Direktivën e shërbimeve mediatike audiovizuale të vitit 2018 (për të cilën afati i fundit për vendin ishte dhjetori i vitit 2022, por më pas u shty deri në maj 2023), projekti u nda në dy faza: (1) në fazën e parë, e cila zgjati deri në korrik 2023, Ligji për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale u harmonizua me Direktivën e BE për Shërbime Mediatike Audiovizuale të vitit 2018; (2) në fazën e dytë, e cila filloi në mars dhe zgjati deri në dhjetor të vitit 2023, u kryen analiza gjithëpërfshirëse dhe konsultime të gjera me një sërë palësh të interesuara dhe u përgatitën ligje të reja mediatike, me qëllim që të zgjidhen të gjitha çështjet tjera të rëndësishme për reformat themelore dhe për përafrimin e mëtejshëm me rregullativat e BE-së[15].

Megjithatë, gjatë gjithë procesit të konsultimit, si në fazën e parë ashtu edhe në fazën e dytë, ekipi i ekspertëve (e fillimisht edhe vetë Ministria) u përball me rezistenca serioze, mosmarrëveshje dhe sulme nga përfaqësuesit e Asociacionit maqedonas mediatik (SHMM apo MMA), e cila bashkon televizionet private në nivel shtetëror, veçanërisht rreth çështjes së rikthimit të praktikës së reklamimit shtetëror. Ky asociacion, duke ushtruar presion të madh mbi Qeverinë e atëhershme, arriti të ridrejtojë procesin e ndryshimit të ligjeve, duke krijuar propozimet e veta ligjore që mbronin drejtpërdrejt interesat komerciale të këtij grupi të mediave. Në fund, përkundër opinionit negativ të ekspertëve dhe kundërshtimit të shoqatave gazetareske dhe OJQ-ve, në nëntor të vitit 2023 Qeveria paraqiti në Kuvend propozimin për anulimin e ndalimit të reklamimit shtetëror në mediat audiovizuale, i cili u miratua nga Kuvendi në shkurt të vitit 2024, mu para fillimit të fushatës për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare. Të gjitha propozimet e tjera të zhvilluara nga ekspertët mbetën "në sirtarët elektronikë" të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës Publike, që aktualisht është Ministria e Transformimit Digjital. Pasoja e kësaj "përshtatjeje" të pjesshme të ligjeve mediatike në favor të interesave komerciale të televizioneve të mëdha private, ishte dëmtimi i madh i mbarë procesit për reforma në sektorin e medias dhe vonesa e përsëritur e harmonizimit me rregullativat evropiane.

Rekomandime për veprim të koordinuar në luftën kundër dezinformatave

Nuk është e mundur të jepen rekomandime për rolin e aktorëve të ndryshëm në vend në ballafaqimin efikas me dezinformatat, përfshirë edhe të "shënjuesve të besuar" në vend, pa rekomanduar vazhdimin e procesit të reformave mediatike, i cili në fakt u ndërpre nga "ndërhyrja" e mediave private në krijimin e ligjeve. Prandaj, rekomandimet që i kemi bërë ne si hulumtues në vlerësimin e fundit të gjendjes së pluralizmit mediatik në vend[16], si dhe në kuadër të projektit për reforma mediatike të mbështetur nga Komisioni Evropian në vitin 2023[17], në esencë janë relevante edhe për këtë çështje. Këtu do të veçoj vetëm disa prej tyre dhe posaçërisht do të theksoj dhe plotësoj ato që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me çështjen që është objekt i kësaj analize – dezinformatat dhe roli i "shënjuesve të besuar".

Rekomandime për kornizën strategjike dhe ligjore

Autoritetet publike, në partneritet me organizatat e shoqërisë civile, mediat dhe palët e tjera, duhet të krijojnë politika publike, strategji dhe mekanizma për rritje të qëndrueshmërisë ndaj dezinformatave dhe për zhvillim të edukimit mediatik, duke pasur parasysh se kjo çështje është e sigurisë që shkon përtej sferës mediatike dhe nënkupton përfshirje dhe veprim të përbashkët të të gjitha institucioneve kompetente shtetërore;

Ministria e Transformimit Digjital duhet të vazhdojë procesin e reformave në media, bazuar në analizat dhe propozimet për ligjet e reja mediatike të zhvilluara nga ekspertët, si pjesë e projektit "BE për lirinë e shprehjes: Harmonizimi i legjislacionit nacional për mediat me ligjin e BE-së dhe standardet evropiane mediatike". Të gjitha analizat, mendimet dhe propozimet e ekspertëve duhet të publikohen dhe t›u dërgohen të gjitha palëve të interesuara;

Kjo nënkupton edhe zbatimin e një faze të re (të tretë) të procesit të reformave meditike, me mbështetje eventuale nga Komisioni Evropian, brenda së cilës do të zhvillohen propozime konkrete për përafrimin me Rregullativën e shërbimeve digjitale dhe Rregullativën evropiane për lirinë e medias;

Duke u nisur nga përvojat e më shumë vendeve anëtare të BE, rekomandohet që roli i Koordinatorit digjital të ushtrohet nga organi nacional rregullator i medias, shërbimi profesional i të cilit ka ekspertizë të gjerë në këto çështje dhe që veçmë merr pjesë në punën e Grupit të rregullatorëve evropianë, i cili së shpejti do të reformohet në Bord Evropian për shërbime mediatike;

Rekomandohet që brenda organit që do të caktohet si koordinator digjital, të krijohet një Grup punues i përhershëm, i përbërë nga të gjithë aktorët relevantë, i cili do të koordinojë aktivitetet për luftë kundër dezinformatave;

Organi, të cilit do t'i besohet roli i koordinatorit digjital, duhet të jetë i autorizuar me ligj për të emëruar shënjues të autorizuar dhe për të miratuar udhëzime specifike dhe kritere strikte për përzgjedhjen e shënjuesve të besuar. Në këtë

drejtim, vëmendje e madhe duhet t'i kushtohet angazhimit të organizatave hulumtuese që kanë njohuri solide metodologjike për kryerjen e hulumtimeve në fushën e dezinformatave dhe misinformatave;

Autoritetet publike duhet të mbështesin rolin e rëndësishëm që luan gazetaria e lirë, e pavarur dhe profesionale në luftën kundër dezinformatave, duke parashikuar në Ligjin për Media një Fond të veçantë për pluralizëm dhe inkurajim e mbështetje të gazetarisë së pavarur dhe cilësore.

Mjetet nga Fondi për pluralizëm, si dhe fondet e destinuara për reklamim partiak-politik gjatë zgjedhjeve ose për reklamim shtetëror, duhet të jenë në dispozicion vetëm për mediat që respektojnë rregullat për transparencë të pronësisë dhe që i përmbahen Kodit të etikës të gazetarëve të Maqedonisë.

Rekomandime për ekspozimin e dezinformatave dhe forcimin e standardeve profesionale në raportimin mediatik

Organizatat qytetare dhe hulumtuese që punojnë në ndjekjen dhe ekspozimin e dezinformatave dhe përmbajtjeve të tjera jolegale në hapësirën onlajn duhet të vazhdojnë dhe të forcojnë metodologjikisht projektet dhe iniciativat e tyre, me qëllim që të zhvillohet një strukturë kredibile e shënjuesve të mundshëm të autorizuar;

Këshilli i etikës në media duhet të vazhdojë të punojë drejt forcimit të standardeve profesionale dhe etike në raportim, përmes punës së Komisionit të ankesave, hartimit të udhëzimeve dhe drejtimeve, kryerjes së trajnimeve për mediat dhe publikun e gjerë, si dhe iniciativave dhe aktiviteteve të tjera;

Mediat profesionale duhet të marrin pjesë aktive në luftën kundër të gjitha llojeve të dezinformatave, përmes forcimit të kontrollit editorial dhe verifikimit të fakteve në përmbajtjet që i publikojnë;

Reklamuesit dhe agjencitë e reklamave duhet të angazhohen në kodet e tyre se nuk do të vendosin reklama në ueb lokacione të dyshuara për përhapjen e dezinformatave ose nuk do të pranojnë kompensim nga burimet që përhapin dezinformata.

Rekomandime për zhvillimin e arsimimit mediatik dhe digjital

Rregullatori mediatik duhet të vazhdojë të koordinojë aktivitetet e aktorëve të ndryshëm për zhvillimin e arsimimit mediatik, në kuadër të Rrjetit tashmë të zhvilluar dhe efikas të arsimimit mediatik;

Ministria e Arsimit duhet të përfshijë konceptin e arsimimit mediatik në strategjinë për transformimin e sistemit arsimor formal në vend dhe të prezantojë iniciativa të reja për të përmirësuar aftësinë e nxënësve për të detektuar dezinformatat dhe për t'u mbrojtur nga ndikimi i tyre;

Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe sektorin privat, duhet të zhvillojë dhe zbatojë një program falas për arsimim mediatik dhe digjital për grupmoshat e ndryshme të popullatës, përfshirë kategoritë e prekshme të qytetarëve;

Organizatat e shoqërisë civile duhet të vazhdojnë të zbatojnë aktivitete për të rritur vetëdijesimin kritik dhe aftësitë e arsimimit mediatik dhe digjital që synojnë të gjitha grupet e popullsisë.

(Autorja është doktore e shkencave sociologjike dhe eksperte në fushën e ligjit të medias dhe politikës mediatike)

Referencat:

1 Shih në: A Europe Fit for the Digital Age.
2 Shih: Regulation (EU) 2022/2065 of the European Parliament and of the Council of 19 October 2022 on a Single Market For Digital Services and amending Directive 2000/31/EC (Digital Services Act) (Text with EEA relevance).
3 Shih: Regulation (EU) 2022/1925 of the European Parliament and of the Council of 14 September 2022 on contestable and fair markets in the digital sector and amending Directives (EU) 2019/1937 and (EU) 2020/1828 (Digital Markets Act) (Text with EEA relevance)
4 Shih: Communication from the Commission – Commission Guidelines for providers of Very Large Online Platforms and Very Large Online Search Engines on the mitigation of systemic risks for electoral processes pursuant to Article 35(3) of Regulation (EU) 2022/2065
5 Shih: Inside Google's Plans to Combat Misinformation Ahead of the E.U. Elections, Time, 25.04.2024.
6 Shih: Commission opens formal proceedings against Facebook and Instagram under the Digital Services Act, European Commission, 30.04.2024.
7 Shih në: Digital Services Coordinators, European Commission, 1.02.2025.
8 Shih: Article 22 Trusted Flaggers Application Form and Guidance, 16.02.2024.
9 Shih: Article 22 Trusted Flaggers Application Form and Guidance, 16.02.2024.
10 Shih: Trusted flaggers under the Digital Services Act (DSA), European Commission, 1.02.2025.
11 Shih: Commission opens formal proceedings against X under the Digital Services Act, European Commission, 18.12.2023.
12 Shih: Commission boosts awareness-raising of the risks of disinformation and information manipulation, 05.06.2024.
13 Shih: ERGA Statement on the progress and challenges within the Code of Practice on Disinformation, 12.2024.
14 Shih: Punëtori "Drejt një sektori mediatik të qëndrueshëm, të llojllojshëm dhe të sigurt: Mbështetja e demokracisë dhe pluralizmit dhe në shërbim ndaj qytetarëve", 12-13.10.2023.
15 Shih: Zbatimi i Monitorit të pluralizmit mediatik në shtetet anëtare të BE-së dhe vendet kandidate në vitin 2023, Raporti nacional: Republika e Maqedonisë së Veriut, 06. 2024.
16 Shih: Zbatimi i Monitorit të pluralizmit mediatik në shtetet anëtare të BE-së dhe vendet kandidate në vitin 2023, Raporti nacional: Republika e Maqedonisë së Veriut, 06. 2024
17 Shih: GUIDELINES for Public Authorities in North Macedonia on addressing "fake news" and "disinformation", Project: "EU for Freedom of Expression: Alignment of national media legislation with EU acquis and media standards", 11.2023.

2. DISTOPIA DIGJITALE DEMOKRATIKE DHE DALJA PREJ SAJ

Autore: SVETLLANA SILJANOVSKA

"Facebook-u nuk u krijua fillimisht për të qenë një kompani. Është ndërtuar për të përmbushur një mision social - për ta bërë botën më të hapur dhe më të lidhur" - Mark Zuckerberg, Facebook, 2012

"T'i organizojmë informacionet e botës dhe t'i bëjmë ato të qasshme dhe të dobishme universalisht" - Larry Page dhe Sergey Brin, Google 2004.

"Ta bëjmë të përsosur çdo detaj dhe të kufizojmë numrin e detajeve që duhet të përmirësohen" - Jack Dorsey, Twitter, 2006.

Tre nga milion deklarata vizionare, të bëra nga themeluesit e platformave digjitale për synimet e tyre në ngritjen e kompanive, pa të cilat nuk mund ta imagjinojmë jetën dhe funksionimin profesional sot.

Në vitin 2025, Facebook-u lidhi njerëzit, por i mbylli përdoruesit e tij në flluska, të ashtuquajturat dhoma të jehonës, me algoritëm që nuk lejon ekspozimin ndaj ideve dhe njerëzve të rinj dhe është një hapësirë për polarizim dhe çrregullim të shëndetit mendor. Facebook-u në vitin 2025 është një hapësirë digjitale ku më i zhurmshmi, më i mllefosuri, më i pranishmi dhe, më e rëndësishmja, ai-që-paguan-më-shumë dominon eterin dhe fiton prej tij. Google nuk e bëri informacionin të disponueshëm universalisht, por përkundrazi, vendosi një çmim mbi të dhe u dha avantazhin e shikueshmërisë atyre që mund të paguanin për të. Twitter-i është ndoshta historia më e zymtë nga këto të tre deri më tani, bile edhe në epokën e Dorsey-t, kur veçmë lejoi fermat artificiale të bot-ëve dhe trollëve të dominojnë diskursin me gjuhën e urrejtjes që përhapet në sekonda, ndërsa hapësira digjitale e destinuar për një revolucion të mikroblogut me vetëm 140 karaktere teksti u shndërrua në një platformë për ekstremizëm politik, promovim dhe nxitje të dhunës, si dhe përhapje masive të dezinformatave. Pasi e mori Musk-u, u bë një platformë që as nuk vlen të krahasohet me idenë origjinale.

Por, pa përjashtim, të gjithë themeluesit dhe pronarët, përveç misionit të tyre "fisnik e filantropik", fituan edhe diçka tjetër - përfitime miliardash dhe vendin e tyre në tryezën që e përcakton gjeopolitikën, demokracinë dhe paqen në botë.

Poenta e veçimit të këtyre tre nga miliona deklarata vizionare që mund të gjenden për çdo themelues ose pronar të çdo platforme digjitale nuk është t'i verifikojë ato, por të vendoset një pikënisje, të cilës duhet t'i rikthehen shtetet dhe aktorët e tjerë demokratik që luftojnë dezinformatat dhe operacionet e ndikimit përmes informacioneve, kur kërkojnë përgjigje për pyetjen "si arritëm në këtë gjendje sot?". Situata, në të

cilën algoritmet e mediave sociale polarizojnë palët në ekstremizëm, duke promovuar agresion dhe dhunë, nuk mund të çojë në asgjë tjetër përveç konfliktit.

Në të njëjtën kohë, poenta e rikujtimit të epokës, në të cilën mediat sociale ishin mjete për demokratizim dhe qasje në informacion, është gjithashtu kthimi në rolin e mediave sociale në shoqëri, të cilin çdo aktor demokratik duhet ta mbrojë dhe ta kërkojë nga qeveria, gjegjësisht shteti i tij.

Në Evropë, gjegjësisht në Bashkimin Evropian, ku veçmë ekzistojnë rregullativat për platformat digjitale, kthimi në vështrimin e funksioneve të mediave sociale në drejtim të forcimit të demokracisë mund të ndihmojë në përcaktimin e lëshimeve në rregullativën e tillë dhe përmirësimin e saj. Megjithatë, të paktën deri tani, nuk ka asnjë inkurajim qeveritar në Bashkimin Evropian për de-rregullim të mediave sociale dhe platformave digjitale.

Në pjesën tjetër të Evropës, e veçanërisht në Ballkanin Perëndimor dhe në Maqedoninë e Veriut, e cila nuk është pjesë e Bashkimit Evropian, mungesa e plotë e rregullimit të mediave sociale duhet parë si një mundësi për të rikthyer disa nga funksionet bazë dhe mekanizmat mbrojtëse që mund t'i kenë mediat sociale. Me supozim se Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut kanë vullnet politik për një hap të tillë, institucionet kanë mundësi unike për t'i mbrojtur qytetarët nga polarizimi dhe ekstremizmi që do t'i shtyjnë ata drejt konfliktit, e me këtë edhe drejt jostabilitetit në vend.

Një shënim anësor, por i rëndësishëm për këtë analizë, është se kur vështrohen dezinformatat më tej në tekst, ato nuk duhet parë nga këndvështrimi ideologjik majtas-djathtas, por më tepër përmes një prizmi demokratik-jodemokratik. Megjithëse ka studime që hulumtojnë elitat dhe partitë politike [1] që kanë arritur në përfundimin se populizmi radikal i djathtë është shtytësi më i fortë i përhapjes së dezinformatave[2], megjithatë në këtë analizë nuk merret parasysh shqyrtimi ideologjik. Problemi me dezinformatat, e rrjedhimisht edhe me dezinformatat në mediat sociale, është një problem në të cilin ka thjesht dy anë: demokratë dhe anti-demokratë. Të parët që luftojnë për të ruajtur demokracinë me metoda demokratike, dhe të dytët që luftojnë për ta shfuqizuar atë me metoda jodemokratike. Çdo gjë tjetër është një grep që largon fokusin nga thelbi.

Vendi i mediave sociale në hartën e dezinformatave dhe operacioneve për ndikim përmes informatave

Vendi i mediave sociale në hartën e dezinformatave mund të përcaktohet në dy mënyra, njëra - nëse analizohen shprehitë dhe tendencat e konsumimit të tyre nga përdoruesit dhe e dyta - nëse ato analizohen si burime ose si mundësues i burimeve të informacionit.


Nëse analizojmë shprehitë dhe tendencat e konsumimit të tyre nga përdoruesit, mediat sociale zënë sërish vendin qendror në hartën e dezinformatave dhe operacioneve të ndikimit përmes informacioneve në Maqedoninë e Veriut, për disa arsye.

Sipas të dhënave të DataReportal[3] të vitit 2024, në Maqedoninë e Veriut ka 1,82 milionë përdorues të internetit dhe depërtimi i internetit është 87,2%. Është e rëndësishme të theksohet se këto janë numra të profileve aktive deri te të cilët arrin përmbajtja e sponsorizuar, e jo të gjitha profilet ekzistuese. Në të njëjtën kohë, duhet të kemi parasysh se

çdo përdorues i internetit nuk është një individ i vetëm, sepse kemi persona fizikë dhe juridikë me tepër llogari përdoruesish. Në vitin 2024, ka mbi 944.600 profile të mediave sociale në Maqedoninë e Veriut, që është e barabartë me rreth gjysmën e popullsisë.

Facebook	944 600	+30 000
Instagram	811 500	+100 000
TikTok	754 000	/
X	133 100	-311 000[4]


Sipas të dhënave të Statista[5], Facebook-u është pa diskutim platforma më e vizituar në Maqedoninë e Veriut për vitin 2023.



Uebfaqet kryesore të mediave sociale në Maqedoninë e Veriut në vitin 2023, bazuar në numrin e vizitave, burimi: statista.com

Nëse të dhënat nga Statista dhe DataReportal tregojnë se kemi një numër të madh përdoruesish aktivë në mediat sociale, hulumtimi që Fondacioni Metamorfozis kreu në vitin 2022[6] mbi efektin e dezinformatave dhe ndikimeve të huaja në proceset në Maqedoninë e Veriut, tregon se si qytetarët i përdorin mediat sociale dhe çfarë efekti kanë ato në bindjet e tyre.

Edhe pse stacionet televizive kanë primatin si kanal për informim, mediat sociale - me portalet e internetit që kanë gjithashtu profilet e tyre në mediat sociale, grumbulluesit e lajmeve dhe influencuesit, kanalet e të cilëve janë përsëri në mediat sociale - tejkalojnë shifrat e mediave tradicionale.




Efekti i dezinformatave dhe ndikimeve të huaja në proceset demokratike në Maqedoninë e Veriut, 2022, burim: Fondacioni Metamorfozis

Më e rëndësishmja, kur pyeten se deri në çfarë mase u besojnë këtyre kanaleve të informacionit, pamja që shfaqet është në përpjesëtim të zhdrejtë. Me fjalë të tjera, mediat sociale, portalet e internetit dhe influencuesit nuk gëzojnë besimin e qytetarëve dhe, që në pyetjen e radhës se kush përhap dezinformata, i tregojnë edhe ata, së bashku me politikanët dhe gazetarët.



Burimi: Fondacioni Metamorfozis

Ndonëse qytetarët kanë treguar se nuk u besojnë burimeve nga të cilat marrin informacionin e tyre, pyetja tjetër në këtë sondazh, në të cilën shtrohen tetë narrativa dezinformuese dhe teori të konspiracionit,[7] vihet re se fushatat e dezinformimit dhe operacionet për ndikim përmes informacionit kanë impakt në bindjet e qytetarëve.



Burimi: Fondacioni Metamorfozis


Duhet pasur parasysh se këto shifra dhe tendenca janë për popullatën e përgjithshme, ndërsa nëse veçohet kategoria e të rinjve - shifrat e mësipërme do të bëhen edhe më drastike.

Nëse analizohen si burime apo mundësues burimesh, mediat sociale zënë një vend qendror në hartën e dezinformatave dhe operacioneve të ndikimit përmes informatave në Maqedoninë e Veriut. Siç konfirmojnë shembujt e mëposhtëm, mungesa e rregullimit të rrjeteve sociale, por edhe zbatimi joefektiv i rregullativës ekzistuese, e inkurajon hapësirën për shpërndarje të koordinuar të përmbajtjeve dezinformuese dhe operacionet e ndryshme për ndikim përmes informacionit, të cilat synojnë të manipulojnë hapësirën e informacionit, të ndikojnë në diskursin publik dhe të shkaktojnë polarizimin sa më të fuqishëm, i cili jo rrallëherë edhe radikalizohet.

Rasti i Velesit[8] i vitit 2016, e ka pozicionuar Maqedoninë e Veriut në listën e vendeve, në të cilat industria e operativëve që krijojnë lajme të rreme dhe dezinformata përmes faqeve në Facebook është e mundësuar, legale dhe kushton lirë në suaza globale. Një grup adoleshentësh hapën mijëra faqe në Facebook, ku mblodhën audiencë përmes përmbajtjeve të ndryshme të përditshme, deri në fushatat zgjedhore – kur filluan të shpërndanin lajme të rreme dhe dezinformata në mënyrë të koordinuar dhe të organizuar, duke sulmuar dhe delegjitimuar kandidaten e atëhershme demokrate për presidente të SHBA-së, Hillary Clinton. Në të njëjtën kohë, rasti i Velesit demonstroi edhe të ashtuquajturin dimension fiskal të dezinformimit, në të cilin jo çdoherë prapa krijimit qëndron ndonjë luftë ideologjike ose politike për ndikim dhe kontroll mbi narrativën, por monetizimi i një shërbimi. Më e rëndësishmja, ky rast e demaskoi vendosjen e praktikës së përdorimit të dezinformatave dhe operacioneve të ndikimit përmes informacionit për qëllime politike, duke ndikuar në zgjedhjet amerikane. Filmi dokumentar "Agjentët e kaosit"[9] do të tregojë më vonë se ndikimi në zgjedhjet e vitit 2016 në SHBA ishte një operacion shumë më i gjerë rus i ndikimit përmes informatave dhe dezinformatave.

Përdorimi i mediave sociale si burim i dezinformatave dhe operacioneve të ndikimit përmes informacionit në Maqedoninë e Veriut nuk është praktikë e krijuar për të ndikuar në procese ekskluzivisht jashtë vendit. Referendumi për ndryshimin e emrit të vendit dhe procesi i anëtarësimit në NATO në vitin 2018 është një periudhë, në të cilën është dokumentuar aksion i koordinuar dhe i organizuar për ndikim mbi diskursin publik, por gjithashtu edhe për sulm të koordinuar ndaj kundërshtarëve politikë përmes llogarive në Twitter, si dhe përmes faqeve dhe grupeve të hapura në Facebook.

Është dokumentuar rrjeti[10] në Twitter, i cili, sipas përmbajtjes së postimeve në profile është i së djathtës radikale dhe lidhet në mënyrë të pavarur në tweet-et e tij me lëvizje si Qanon, megjithëse edhe sinkronizimi me Rusinë rreth prodhimit të dezinformatave[11] në mediat sociale ishte i dukshëm, siç ishin edhe elementët tjerë, për shembull protestat kundër referendumit, financimi i të cilave lidhet me biznesmenë nga Rusia[12]. Nga kjo fushatë nuk mbetën jashtë edhe profilet e të majtës radikale në rrjetet sociale. Brenda vendit, ata treguan mbështetje ose lidhje me të gjitha partitë opozitare që zyrtarisht ose jozyrtarisht kërkuan bojkotimin e referendumit, duke përfshirë partitë VMRO-DPMNE, Levica (E Majta), Maqedonia e Bashkuar dhe të tjera.



Accounts that retweeted, mentioned and quoted #Бојкотира on Twitter. The accounts mentioned pushed the campaign the most and had a large network of supporters who retweeted the hashtag. (Source: Graphistry / Data: Dropbox.com)

Burimi: medium.com, DFRLab, shtator 2018

Komentet joautentike të koordinuara që sulmojnë politikat institucionale janë dokumentuar edhe në vitin 2019[13], me përmbajtje që shkakton tensione ndëretnike dhe polarizim në vija etnike. Operacionet e ndikimit përmes informacionit u dokumentuan edhe në vitin 2021 gjatë organizimit të Regjistrimit të popullsisë[14]. Në vitin 2024[15], u hartua qartë edhe rruga që shpie nga deklaratat politike të politikanëve në pushtet, përmes mediave, deri te publikimet e koordinuara të dezinformatave në grupe dhe faqe publike të Facebook-ut. Profilet dhe faqet në Facebook, të cilat shpërndajnë në mënyrë të koordinuar përmbajtje të njëjtë, përdorin kryesisht manipulime me informata.

Ajo që është e përbashkët në të gjitha këto raste të mësipërme është se, pa përjashtim, të gjithë promovojnë një narrativë antiperëndimore me gjuhë intensive të polarizimit dhe ekstremizimit të audiencës së tyre. Ideologjikisht majtas apo djathtas, grupet janë të bashkuara në radikalizmin e tyre, i cili, me këto operacione për ndikim përmes informacionit, synon të minojë besimin dhe të delegjitimojë rendin demokratik dhe Perëndimin[16].

Çfarë do të thotë heqja e kontrolluesve të fakteve dhe moderimit të përmbajtjes në Facebook dhe si do të ndikojë në grupet vulnerabël?

Kur bëhet fjalë për TikTok dhe X (Twitter), nuk ka shumë vend për analizë të moderimit të përmbajtjes, e as për përhapjen e dezinformatave. Telegrami është një histori e padiskutueshme në vetvete, jo vetëm në shpërndarjen e dezinformatave, por edhe në krijimin e komuniteteve që i përhapin ato, si dhe pozicionimin si një lloj "ure" me rrjetet e tjera sociale.[17]

Sipas faqes zyrtare të TikTok[18], moderimi i përmbajtjes bëhet fillimisht përmes një sistemi të automatizuar të AI që mënjanon automatikisht përmbajtjen e dhunshme, ose përmes raportimit nga ndonjë përdorues - në këtë rast një moderator e shqyrton dhe heq përmbajtjen, megjithëse këta të fundit do të përjetojnë pushime masive nga puna[19]

në vitin 2024, me pretekstin se 80% e përmbajtjes është veçmë e detektuar nga AI. Efikasiteti i moderimit të përmbajtjes mund të vlerësohet nëpërmjet ekzistimit të grupeve neo-naziste në TikTok[20], përmbajtja e të cilëve është amplifikuar algoritmikisht, edhe pse mes tjerash shpërndan edhe dhunë të hapur të raportuar nga përdorues të tjerë.

Facebook, ose Meta, ishte një bastion i mediave sociale, moderimi i përmbajtjes së të cilit dhe bashkëpunimi me shërbimet e verifikimit të fakteve siguronte njëfarë mbrojtjeje për përdoruesit nga dezinformatat, gjuha e urrejtjes, shënjestrimi dhe ngacmimi mbi çfarëdo lloj baze, përmbajtjet e dhunshme ose përmbajtjet që promovojnë ekstremizmin dhe radikalizmin, si dhe përmbajtjet që inkurajojnë vetëlëndimin dhe vetëvrasjen.

Në lidhje me këtë analizë, Meta kishte edhe mekanizma me të cilët mund të zbulonte sjellje joautentike, pra profile të rreme dhe veprime të koordinuara që ndikojnë në diskursin publik. Në rastet e identifikuara (që sigurisht nuk ishin mbuluar 100%), Meta vepronte relativisht shpejt duke ulur dukshmërinë ose përmes shënjimeve paralajmëruese rreth përmbajtjes, gjegjësisht përmes mënjanimit të përmbajtjes së dëmshme.

Në videon e Zuckerberg[21], në të cilën paralajmërohen ndryshimet e reja që nënkuptojnë heqje të shërbimeve të verifikimit të fakteve dhe kufizimeve të përmbajtjes, ndërsa do të lejohet më shumë përmbajtje politike në shikimet e përdoruesve, ai vetë pranon se kjo do të rrisë informacionin e rremë dhe përmbajtjen manipuluese.

Kjo do të thotë gjithashtu se Meta nuk do të mbajë më përgjegjësi ligjore për përmbajtje të caktuara, të cilat ndër vite kanë kontribuar në humbjen e proceseve gjyqësore miliona-dollarëshe për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve për moderimin dhe shfaqjen e përmbajtjeve të dëmshme që kanë shkaktuar pasoja reale për përdoruesit, siç janë për shembull paditë për shkaktimin e varësisë tek adoleshentët[22].

Zuckerberg i paralajmëron të gjitha këto me pretekstin se kështu po rikthen lirinë e shprehjes. Por, liria e shprehjes, si e drejtë e njeriut, nuk është e pakufizuar. Sipas Paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike[23], çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes, duke përfshirë kërkimin, marrjen dhe dhënien e informacionit dhe ideve, por kjo e drejtë mund të kufizohet nëse është e nevojshme për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve. Kufizime të tilla ekzistojnë gjithashtu kur të shprehurit përmban avokim të urrejtjes nacionale, racore ose fetare që nxit diskriminim, armiqësi ose dhunë.

Përveç Kushtetutës, rregullativa ligjore në Maqedoninë e Veriut njeh disa ligje që parashikojnë kufizime:

- Kodi Penal[24] – edhe atë nëpërmjet nenit 319, i cili sanksionon veprimet që nxisin urrejtje, përçarje dhe jotolerancë nacionale, racore ose fetare; Neni 394-d, i cili parashikon dënime për ata që shpërndajnë materiale përmes sistemeve kompjuterike që nxisin urrejtje ose diskriminim në bazë të racës, etnisë, fesë etj.; Neni 417, i cili sanksionon përhapjen e ideve për epërsinë e një race mbi një tjetër ose nxitjen e urrejtjes dhe diskriminimit racor; Neni 144-a, i cili përcakton veprën e "përndjekjes" dhe parashikon sanksione për të; Neni 190-a, i cili përcakton krimin e "Ngacmimit seksual" dhe parashikon sanksione për të (dy të fundit përfshijnë edhe veprimet me mjete elektronike të komunikimit).
- Ligji për përgjegjësinë qytetare për fyerje dhe shpifje[25], i cili rregullon përgjegjësinë civile për dëmin e shkaktuar ndaj nderit dhe reputacionit të një personi fizik ose juridik me fyerje ose shpifje.
- Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi[26] i cili rregullon parandalimi dhe ndalimi i diskriminimit, format dhe llojet e diskriminimit dhe procedurat për mbrojtjen nga diskriminimi.

- Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale[27] - Ky ligj rregullon mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e privatësisë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.

Ka ligje të tjera që pak a shumë e kufizojnë lirinë absolute të shprehjes, por edhe me ato të përmendurat më sipër, është e qartë se në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ligjërisht mund të mbahet përgjegjësi nëse të shprehurit cenon një të drejtë tjetër të njeriut ose shkakton vepër tjetër penale të parashikuar me ligj.

Moderimi i mëparshëm i përmbajtjes në median sociale më të përdorur në Maqedoninë e Veriut - Facebook, mundësonte njëfarë mbrojtjeje[28] të grupeve vulnerabël, të drejtat e të cilëve mbrohen nga ligjet e sipërpërmendura. Këto grupe përfshijnë të miturit që janë të ekspozuar ndaj mediave sociale, adoleshentët - te të cilët mediat sociale krijojnë vartësi[29] ose i ekspozojnë ndaj përmbajtjeve të dhunshme që nxisin agresionin, viktimat e trafikimit me njerëz, komunitetet e margjinalizuara, njerëzit e rrezikuar nga vetëvrasjet ose vetëlëndimi, e shumë të tjerë.

Kjo mbrojtje nënkuptonte një përgjigje të shpejtë nga platforma ndaj shënjestrimit ose çdo forme të onlajn ngacmimeve, kërcënimeve dhe veprimeve të ngjashme. Njëkohësisht, verifikimi i vazhdueshëm i fakteve të përmbajtjeve dhe shënjimi jepte pasqyrë se cilat burime në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëllimshme krijojnë përmbajtje jolegale ose përmbajtje që shkelin të drejtat e njeriut të grupeve të caktuara. Pa një reagim të tillë të shpejtë, çdo viktimë të cilës i janë shkelur të drejtat nga përmbajtjet e postuara në rrjetet sociale, do të detyrohet të kërkojë drejtësi përmes autoriteteve gjyqësore në vend. Dhe, kjo do të thotë se një numër i madh njerëzish nuk do të kenë fare mundësi ta kërkojnë, për shkak të mosnjohjes së sistemit juridik, mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare apo kushteve për zhvillimin e një procedure etj. Kjo do të thotë se ata do të ekspozohen çdo ditë ndaj diskriminimit, racizmit, ksenofobisë, homofobisë, mizogjinisë, pa mundësinë e mbrojtjes së shpejtë sistematike.

Duhet pasur parasysh se në Maqedoninë e Veriut, aktgjykimi i parë për gjuhën e urrejtjes kundër personave LGBTI[30] në mediat sociale u dha vitin e kaluar (2024) pas një viti të tërë nëpër labirintet e sistemit gjyqësor. Për disa viktima nuk pati drejtësi, ose kishte drejtësi të pjesshme, siç ishte në rastin "Dhoma publike"[31], ku drejtësi fituan vetëm vajzat e mitura në bazë të veprës penale të prodhimit dhe shpërndarjes së pornografisë me persona të mitur, ndërsa viktimat tjera, në mungesë të zgjidhjes ligjore në atë kohë, mbetën pa mekanizëm për fituar drejtësi.

Nga ana tjetër, heqja e moderimit do të inkurajojë ekstremizmin politik, shënjestrimin politik, dezinformatat dhe operacionet e ndikimit përmes informacionit, si dhe amplifikimin dhe radikalizimin e polarizimit.

Dhe, këtu hyjmë në një dimension tjetër - sigurinë. Mediat sociale dhe mungesa e rregullimit të tyre ndikon ndjeshëm në sigurinë në vend. Ato jo vetëm që nxisin tensionet dhe radikalizojnë polarizimin që mund të çojë në konflikte të brendshme dhe destabilizime të mundshme, por gjithashtu mund të ndikojnë në marrëdhëniet ndërfqinjësore dhe të nxisin konfliktet e jashtme në rajon. Mungesa e kontrollit ose së paku e transparencës mbi monetizimin e operacioneve të ndikimit përmes informacionit, përmes infrastrukturës njerëzore, apo përmes përmbajtjeve të sponsorizuara, e bën shtetin të prekshëm ndaj ndikimeve të huaja, të cilat mund të vijnë nga të gjitha llojet e aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë, me një agjendë të paqartë ose një agjendë që është në kundërshtim me interesat shtetërore.

Vlen të përmenden Këshilli për Koordinim të Komunitetit të Sigurisë dhe Zbulimit[32], Komiteti Nacional për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftë Kundër Terrorizmit[33], i cili punon përmes strategjive të veta nacionale, si dhe mekanizmat për parandalimin e radikalizimit onlajn[34], detyra e të cilëve është të sigurojnë që liria e shprehjes (bile edhe në mediat sociale) të mos përfshijë promovimin e terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm, apo radikalizmit (fetar ose të çfarëdo lloji tjetër).

Në një kontekst pak më të gjerë, por ende në rrafshin e sigurisë, mungesa e moderimit të përmbajtjes nga mediat sociale në njërën anë, si dhe mungesa e rregullimit të tyre nga shteti nga ana tjetër, ka një ndikim serioz mbi demokracinë dhe ciklet zgjedhore në vend. Kushtet, në të cilat nuk ka mekanizma mbrojtës për dezinformatat, falsifikimet e thella (deep-fake), manipulimet me përmbajtjet dhe veprimet joautentike, janë kushte në të cilat lulëzojnë operacionet e ndikimit përmes informacionit. E operacione të tilla kanë ndikim në tre segmente të rendit demokratik:

- Për shkak të kakofonisë së komunikimit në eter, në të cilën është e vështirë të përcaktohet një burim i besueshëm informacioni të cilit do t'i besojnë qytetarët, ata sillen në situatë të zgjedhin që të mos informohen për procese apo politika të caktuara, e qytetarët e painformuar marrin vendime të painformuara;
- Fushatat e dezinformimit që synojnë minimin e besimit te demokracia si sistem, institucionet apo kandidatët politikë, i dekurajojnë qytetarët të marrin pjesë në zgjedhje, e kur e bëjnë këtë - e bëjnë të vështirë për qytetarët qasjen në informacion për programet politike për të cilat duhet të votojnë. Kjo më pas krijon pasivizimin e qytetarëve të papërcaktuar dhe mospjesëmarrjen e tyre në proceset demokratike;
- Nëpërmjet gjithëpranisë së vazhdueshme të operacioneve të ndikimit përmes informatave dhe fushatave dezinformuese, qytetarët mashtrohen ekziston rreziku që të marrin vendime bazuar në informacione të pasakta dhe të paverifikuara, gjë që ka rëndësi thelbësore për pjesëmarrjen e tyre në procese si zgjedhjet, regjistrimet e popullsisë dhe referendumet.

Heqja e moderimit të përmbajtjes dhe verifikimit të fakteve nga Meta ka pasur gjithashtu një ndikim të madh në shëndetin mendor të përdoruesve të Facebook dhe Instagram. Duke filluar nga niveli i vartësisë[35] që paraqitet te të gjithë përdoruesit nëpërmjet funksioneve që mundësojnë rikthimin e vazhdueshëm dhe të pafund në rrjetet sociale gjatë gjithë ditës, që në vetvete duhet të trajtohet si çdo vartësi tjetër. Për më tepër, sipas një analize të publikuar nga Nezavisen Vesnik[36] e cila mbështetet në burime të shumta, duke përfshirë hulumtimin e brendshëm të Facebook nga viti 2020, tregon se Instagram përkeqëson imazhin e trupit të çdo vajze të tretë adoleshente që përdor aplikacionin. I njëjti hulumtim sugjeron se krahasimet e inkurajuara nga Instagram mund të çojnë në rritje të ankthit dhe depresionit tek përdoruesit e rinj, madje edhe në mendime vetëvrasëse. Ekspozimi i të rinjve, veçanërisht djemve, ndaj përmbajtjeve të dhunshme shpie në desensibilizim ndaj dhunës në jetën reale[37], e inkurajon sjelljen agresive[38] dhe i ekspozon ata ndaj ndikimeve toksike në të ashtuquajturën "manosferë"[39]. Të rikujtojmë, në vendin tonë ka një sërë shembujsh ku fëmijë të mitur, për shkak të ekspozimit ndaj rrjeteve sociale, i kanë shkaktuar vetes lëndim,e madje edhe vdekje të papritur, siç ndodhi me vajzën 14-vjeçare në Ilinden, e cila humbi jetën nga goditja elektrike[40], si pasojë e një sfide në TikTok.

Së fundi, një dimension tjetër është ai ekonomik dhe mungesa e mbrojtjes nga mashtrimet onlajn përmes lojërave shpërblyese të rreme në mediat sociale[41], e cila ka pasur një rritje të madhe në Maqedoninë e Veriut në vitin e kaluar (2024), ku një numër i madh qytetarësh u mashtruan për të marrë pjesë në lojëra shpërblyese përmes profileve false të kompanive ose përmes reklamave të sponsorizuara nga kompani joekzistente që mundësojnë fitime të shpejta.

Të gjitha këto dimensione i vënë qytetarët para një ekspozimi që kërkon arsimim të lartë mediatike, financiar ose digjital për t›u mbrojtur, ndërsa institucionet mund të veprojnë vetëm pasi të ketë ndodhur dëmi. Prandaj, të gjitha këto dimensione duhet të përfshihen në zhvillimin e zgjidhjeve për rregullativa, të cilat do të kenë në radhë të parë një rol parandalues, e më pas edhe një rol reaktiv.

Ku është rrugëdalja nga kjo distopi demokratike digjitale?

Para se të thellohemi në ndonjë zgjidhje apo rekomandim për rregullativë apo masa, është e rëndësishme të merret parasysh se nuk ka asnjë shtet demokratik në botë që e ka zgjidhur me sukses dhe plotësisht këtë problem. Vende të ndryshme po zbatojnë me më pak apo më shumë sukses zgjidhje që kanë njëfarë efekti, por kjo kushtëzohet nga faktorë që nuk ndryshojnë në afat të shkurtër. Faktorët që ndikojnë në përballimin varen gjithashtu nga ambienti, historia dhe kultura politike e rajonit, që do të thotë se zgjidhjet që funksionojnë në një vend ka shumë pak gjasa të funksionojnë për një vend tjetër, nëse nuk kanë ngjashmëri në kontekstin e përcaktuar historik apo politik.

Si shembull, suksesi dhe rezistenca e shteteve të Baltikut[42] lidhet me nivelin e lartë të besimit tek institucionet dhe mediat, si dhe me inkuadrimin e arsimimit mediatik në sistemin arsimor dekada më parë. Në të njëjtën kohë, ndryshe nga, për shembull, vendet e Ballkanit, ku kundërthëniet[43] janë një tipar kulturor, në vendet baltike ka harmoni kombëtare sa i përket politikës së jashtme dhe të sigurisë, e cila lidhet kryesisht me historinë e trazuar të vendeve dhe me mësimet e nxjerra prej saj[44].

Për shembull, Shqipëria, pas një incidenti në të cilin humbi jetën një adoleshent i ri, e ndaloi TikTok-un[45] për një vit, pasi vërtetoi se ekspozimi i të miturve ndaj përmbajtjeve të dhunshme të pamoderuara inkurajonte dhunën dhe bullizmin. Vende të tjera po kufizojnë plotësisht qasjen në telefonat e mençur në shkolla, si Kalifornia[46], Brazili[47] dhe Teksasi[48], ndërsa Australia ka miratuar një ndalim[49] që do të hyjë në fuqi si ligj në nëntor 2025, duke kufizuar qasjen në mediat sociale për të miturit nën 16 vjeç, ndërsa duke ndjekur të njëjtin shembull, debati publik veçmë është hapur edhe në Mbretërinë e Bashkuar[50].

Pavel Durov, themeluesi i Telegram, u arrestua[51] në Francë, me akuzë se rrjeti mundëson shpërndarjen e përmbajtjes së abuzimit seksual të fëmijëve dhe mbështet aktivitete kriminale. Ky akt e detyroi Durovin të “shkelte” rregullat e privatësisë së rrjetit dhe t’u siguronte autoriteteve të dhëna që do t’i ndihmonin ata të ndjekin penalisht krimet e përmendura, ndërsa më tej ai njoftoi se rrjeti do të fillojë edhe mekanizmat e tij për të “gjuajtur” krimin.[52] Ky hap i Durov motivoi përdoruesit radikalë të krahut të djathtë të braktisin Telegram-in.[53]

Një rast i veçantë është Rumania, ku shërbimet e sigurisë, në mes të zgjedhjeve, paraqitën prova se TikTok[54] po përdorej për të ndërhyrë në zgjedhje dhe ato u anuluan

me vendim të Gjykatës Kushtetuese, ndërsa sipas indikacioneve, Rusia dyshohet se qëndron pas këtij operacioni, megjithëse ende pritet konfirmimi zyrtar për këtë. Menjëherë pas këtij vendimi, autoritetet tatimore njoftuan një hetim për të ardhurat[55] e ndikuesve të TikTok që morën pjesë në fushatë, gjë që i motivoi këta influencues të largoheshin nga vendi. Ky rezultat ishte arsye që Komisioni Evropian të hapte procedurë zyrtare kundër TikTok për ndikim në integritetin e zgjedhjeve.[56] Moldavia arriti ta bindë Meta-n të "shuajë" profilet e rreme,[57] si dhe faqet e grupet e rreme për të cilat është vërtetuar se janë operacion i koordinuar me lidhje ruse për ndikim në referendumin për anëtarësim në BE dhe e shkelin politikën për veprime të koordinuara joautentike, e gjithashtu bllokoi dhjetëra kanale në Telegram që ofronin para për të votuar "Jo" në referendum.

Në bazë të këtyre shembujve nga vende të tjera, ku legjislacioni dhe funksionimi ligjor i shtetit kanë dhënë rezultate konkrete në ballafaqimin me efektet negative të dezinformatave dhe operacioneve të ndikimit përmes informacionit në mediat sociale apo parandalimin e tyre, mund të konstatohet se një nga segmentet që duhet t'i zbatojë Maqedonia e Veriut është pikërisht ai legjislativ.

Siç theksohet në këtë tekst, Maqedonia e Veriut veçmë ka ligje që mund të sanksionojnë gjuhën që shkel një të drejtë tjetër të njeriut, por nuk ka mekanizma për zbatimin e tyre efektiv dhe nuk ka zgjidhje ligjore që hyjnë në rrënjët e problemit me dezinformatat. Ndërsa, zgjidhjet që ekzistojnë nuk kanë rol parandalues dhe proaktiv. Edhe pse Strategjia kombëtare e sigurisë[58] i njeh dhe i trajton dezinformatat si një problem sigurie, ky dokument nuk ka ende një plan veprimi të qeverisë për zbatim, i cili do të trajtonte individualisht shkaqet e ndikimit të dezinformatave dhe operacioneve të ndikimit përmes informatave, siç janë për shembull veprimet e koordinuara dhe joautentike në mediat sociale ose operacionet e ndikimit përmes informacionit të kryera nëpërmjet tyre.

Duhet të kujtohet se Maqedonia e Veriut, si anëtare e NATO-s, ka detyrimin të zbatojë vendimet e Deklaratës së Samitit të Uashingtonit (pika 14)[59] në drejtim të ndërtimit të kapaciteteve individuale për t'u ballafaquar me operacionet e dezinformatave, por edhe një detyrim ndaj nenit 3 të Marrëveshjes Veri-atlantike[60], e cila e detyron shtetin që individualisht dhe kolektivisht të forcojë qëndrueshmërinë e tij dhe në këtë mënyrë qëndrueshmërinë e të gjithëve në Aleancë.

Dhe, ky është vetëm një segment ku Qeveria mund të ndërmarrë hapa të drejtpërdrejtë për adresimin e problemit, pra një segment që mund të mbulohet me rregullativën e ardhshme për rrjetet sociale në vend· Natyrisht, një rregullativë e tillë në të ardhmen duhet të përafrohet me Aktin e Shërbimeve digjitale të Bashkimit Evropian,[61] përafrim i cili veçmë është propozuar si nismë nga Fondacioni Metamorfozis dhe është pranuar nga Qeveria[62]. Maqedonia e Veriut, si vend me negociata të nisura (dhe të ngecura) për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ka për obligim të harmonizojë legjislacionin e saj me atë të BE-së, në mënyrë që negociatat dhe vetë anëtarësimi të ecin më shpejt dhe pa pengesa.

Më e rëndësishmja - ky proces duhet të organizohet që në fillim në një mënyrë gjithëpërfshirëse, përmes një "Qasjeje të gjithë shoqërisë"[63] (Whole of society approach) për të siguruar përfshirjen e të gjitha rrafsheve të shoqërisë (mediatike, akademike, qytetare, institucionale) dhe të sigurohen mekanizma mbrojtës kundër abuzimit nga autoritetet.

Qasja mbarëshoqërore ndaj problemit të trajtimit të dezinformatave dhe operacioneve të ndikimit përmes informacionit në mediat sociale përfshin edhe aktorë të tjerë

në shoqëri. Disa prej tyre mbulohen përmes rekomandimeve të Fondacionit Metamorfozis për Efektin e dezinformatave dhe ndikimeve të huaja në proceset demokratike në Maqedoninë e Veriut[64], ku thuhet:

- Është e nevojshme ngritja e nivelit të integritetit të medias përmes rritjes së respektimit të standardeve profesionale dhe etike në gazetari, si dhe rritjes së aplikimit dhe dukshmërisë së mekanizmave të vetërregullimit. Mediat duhet të inkuadrojnë mekanizma të brendshëm për të rritur rezistencën e tyre ndaj dezinformatave përmes kyçjes së procedurave për verifikim të fakteve, ndërsa në nivel të politikave editoriale të kenë prioritet raportimin proaktiv mbi rrjedhat e dezinformatave, së bashku me promovimin e arsimimit mediatik dhe digjital.
- Mediat duhet të angazhohen për transmetimin e përmbajtjeve të verifikuara nga shërbimet e verifikimit të fakteve apo media të tjera, si dhe nga organizatat e shoqërisë civile që ekspozojnë rregullisht dezinformatat dhe narrativat dezinformuese në kuadër të punës së tyre.
- Është e nevojshme të ngrihet niveli i debatit publik mbi kontekstin gjeopolitik, rrjedhën e dezinformatave, burimet e tyre dhe interesave që promovojnë ato, veçanërisht tendencat antidemokratike që lidhen me ndikimin e regjimeve të huaja autoritare. Institucionet shtetërore, komuniteti akademik apo shkencoro-arsimor, mediat dhe shoqëria civile kanë për detyrë që të informojnë në mënyrë proaktive qytetarët për këto gjendje, përmes narrativave pozitive të bazuara në fakte, përmes përmbajtjeve informative dhe edukative, debateve publike të bazuara në hulumtime gazetareske dhe analiza të ekspertëve.
- Krijuesit e opinionit publik duhet të kenë parasysh se mungesa e informimit dhe debatit përmbajtjesor publik shpie në boshllëqe informacioni, të cilat ofrojnë hapësirë për veprim të ndikimeve të jashtme malinje mbi perceptimet e qytetarëve, me synim për të minuar demokracinë. Prandaj është e rëndësishme që njohja dhe shqyrtimi kritik i narrativave dezinformuese të bëhen pjesë integrale e të gjitha formave të komunikimit publik dhe krijimit të përmbajtjeve.

Këtyre rekomandimeve mund t'u shtohet se është i nevojshëm një angazhim më thelbësor nga komuniteti profesional, veçanërisht nga organizatat si SHGM dhe KEMM, në veçimin e mediave profesionale dhe profilizimin e tyre në mediat sociale si burim i besueshëm i informatave. Sidomos nëse ky proces vjen jo vetëm nga formimi i regjistrave, por edhe nga inicimi i mekanizmave të brendshëm në media për ballafaqim me dezinformatat dhe operacionet e ndikimit përmes informacionit.

Një angazhim më thelbësor duhet të ndërmerret edhe nga ASHMAA si një rregullator që mund të udhëheqë ndryshimet ligjore dhe proceset që lidhen me rregullimin, por edhe të udhëheqë fushata publike për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me operacionet e ndikimit përmes informacionit.

(Autorja është konsulente për komunikime strategjike me fokus në ballafaqimin me dezinformatat)

Referencat:

1 Studim: Kur gënjejnë partitë? Informatat e gabueshme dhe populizmi i djathtë radikal në 26 vende, "When Do Parties Lie? Misinformation and Radical-Right Populism Across 26 Countries", e qasshme në: https://doi.org/10.1177/19401612241311886 The International Journal of Press/Politics, Törnberg, P., & Chueri, J. (2025)

2 Publikim i The Guardian: "Far-right populists much more likely than the left to spread fake news – study", e qasshme në: https://www.theguardian.com/world/2025/feb/11/far-right-mps-fake-news-misinformation-left-study, The Guardian, Jon Henley, 11 shkurt 2025

3 Raport mbi tendencat digjitale në Maqedoninë e Veriut për vitin 2024, Digital 2024: North Macedonia, në dispozicion në: https://datareportal.com/reports/digital-2024-north-macedonia Simon Kemp, Data Reportal, 23 shkurt 2024

4 Sipas të dhënave të X, ka pak më shumë se 1000 përdorues të rinj, por sipas të dhënave nga reklamuesit që mund të arrijnë deri te përdoruesit përmes përmbajtjes së sponsorizuar, ka një rënie prej mbi 300.000.

5 Publikimi i Statista: Uebfaqet kryesore të mediave sociale në Maqedoninë e Veriut në vitin 2023, bazuar në numrin e vizitave, në dispozicion në: https://www.statista.com/statistics/1165984/market-share-of-the-most-popular-social-media-websites-in-north-macedonia/ , Statista, Statista Research Department, 12 nëntor 2024

6 Hulumtimi: Efekti i dezinformatave dhe ndikimeve të huaja në proceset demokratike në Maqedoninë e Veriut, në dispozicion në: efektot-na-dezinformaciite.pdf, Fondacioni Metamorfosis, 2022

7 Përmbledhje e analizave dhe fakteve: Manipulimi i diskursit publik - dezinformim dhe propagandë, në dispozicion në: https://vistinomer.mk/wp-content/uploads/2024/02/manipuliranje-na-javniot-diskurs_fjnal_mk_web.pdf , Fondacioni "Metamorfosis", 2024

8 Hulumtimi: Industria maqedonase e lajmeve të rreme dhe Zgjedhjet në SHBA 2016, në dispozicion në: The Macedonian Fake News Industry and the 2016 US Election | PS: Political Science & Politics | Cambridge Core Shtypi Universitar i Cambridge, 25 gusht 2020

9 Shpallje në portalin Indiwire: "Agjentët e kaosit" nga Alex Gibney "Agents of Chaos": HBO Drops Trailer for Doc on Russian Interference, HBO, 23 shtator 2020

10 Botuar në Medium.com: #ElectionWatch: Fushata Bojkot në Maqedoni përmban personazhe të njohur, në dispozicion në: #ElectionWatch: Boycott Campaign in Macedonia Features Familiar Characters | by @DFRLab | DFRLab | Medium, DFR Lab, 14 shtator 2018

11 Analizë: "Propaganda ruse me dezinformata në Maqedoni para referendumit të vitit 2018", në dispozicion në në: Руската пропаганда со дезинформации во Македонија пред референдумот во 2018 – Truthmeter, Vërtetmatës, Zharko Trajanovski, 12 prill 2022

12 Botuar në portalin 360 Gradë: "Hulumtim: Si e minoi Rusia referendumin për emrin në Maqedoninë e Veriut?", në dispozicion në: Истражување: Како Русија го подриваше референдумот за името во Северна Македонија? - 360 степени, 360 gradë, Maja Vaseva Trajkova, 10 janar 2020

13 Analiza: "Komentet e koordinuara në Maqedoni", në dispozicion në: Coordinated Comments in Macedonia - DFRLab, DFR Lab, 21 janar 2019

14 Botuar në portalin Vërtetmatës: "Rrjetet sociale të vërshuara nga dezinformata për regjistrimin", në dispozicion në: Социјалните мрежи преплавени со дезинформации за пописот – Truthmeter, Vërtetmatës, Simona Atanasova, 12 shtator 2021

15 Analizë: "Marrëdhëniet ndëretnike të humbura në Trekëndëshin e Bermudës të qeverisë, mediave dhe rrjeteve sociale$, në dispozicion në: Меѓуетничките односи изгубени во Бермудскиот триаголник на Владата, медиумите и социјалните мрежи – Truthmeter, Vërtetmatës, 12 dhjetor 2024

16 Analizë: "Të majtët dhe të djathtit në Maqedoninë e Veriut po përhapin "vëllazërisht" narrativa dezinformuese anti-perëndimore", në dispozicion në: https://vistinomer.mk/levite-i-desnite-vo-severna-makedonija-bratski-gi-shirat-antizapadnite-dezinformaciski-narativi/, Vërtetmatësi, 9 janar 2025

17 Hulumtim: "Rreziqet e paadresuara të kanaleve publike të Telegram dhe hapat që duhen ndjekur", në dispozicion në: Telegram public channels: risks and steps to follow - Maldita.es - Periodismo para que no te la cuelen Fundación Maldita.es së bashku me Universitetin e Granadës, 26 shtator 2024

18 Faqja zyrtare e kompanisë TikTok që përshkruan moderimin e përmbajtjes, në dispozicion në: tiktok.com/euonlinesafety/en/content-moderation/

19 Botuar në Reuters, në dispozicion në: ByteDance's TikTok cuts hundreds of jobs in shift towards AI content moderation | Reuters, Reuters, Rozanna Latiff, 11 tetor 2024

20 Analizë: "NazTok: Një rrjet i organizuar neo-nazist në TikTok po merr miliona shikime", në dispozicion në: NazTok: An organized neo-Nazi TikTok network is getting millions of views - ISD, Instituti për dialog strategjik, Nathan Doctor, Guy Fiennes dhe Ciarán O'Connor, 29 korrik 2024

21 Video nga Mark Zuckerberg, në dispozicion në: It's time to get back to our roots around free expression. We're replacing fact checkers with Community Notes, simplifying our policies and focusing on... | By Mark Zuckerberg | Facebook, Mark Zuckerberg, 7 janar 2025

22 Raporti i Reuters: "Meta duhet të përballet me padi të shtetit amerikan për varësinë e adoleshentëve në mediat sociale", në dispozicion në: Meta must face US state lawsuits over teen social media addiction | Reuters, Reuters, Brendan Pierson, 16 tetor 2024

23 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut, në dispozicion në: Меѓународен пакт за граѓански и политички права - Manual for Human Rights Education with Young people, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, e miratuar më 16 dhjetor 1966

24 Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në: LBDIS shqyrtim i ligjit , botuar në Gazetën Zyrtare nr.36, 17 shkurt 2023

25 Ligji për përgjegjësi civile për fyerje dhe shpifje i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në: Microsoft Word - Sluzben del 251_2022

26 Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në: Закон за спречување и заштита од дискриминација.pdf, botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 258, 30 tetor 2020

27 Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, në dispozicion në: zakon_za_zastita_na_licnite_podatoci.pdf , botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë, nr. 42, 16 shkurt 2020

28 Efektiviteti i mbrojtjes është ulur në mënyrë drastike për shkak të përdorimit të "algo-gjuhës" që mashtron algoritmet e AI që monitorojnë përmbajtjen duke përdorur fjalë përshkruese për të shprehur të njëjtën ofendim pa përdorur fjalë të qarta.

29 Botuar në portalin Fakulteti.mk: "Si Facebook dhe Instagram na shndërrojnë në të vartur", në dispozicion në: Како „Фејсбук" и „Инстаграм" нè претвораат во зависници B.B. Faktulteti.mk, 28 shkurt 2018

30 Botuar në Radio MOF: "Vendimi i parë në Maqedoni për gjuhën e urrejtjes ndaj personave LGBTI+ në rrjetet sociale", në dispozicion në: Прва пресуда во Македонија за говор на омраза кон ЛГБТИ+ лицата на социјалните мрежи, Radio MOF, 29 mars 2024

31 Botuar në Radio Evropa e Lirë/Radio Liberty: "Një rrugë me thera drejt drejtësisë për viktimat e Dhomës Publike", në dispozicion në: Трнлив пат до правда за жртвите од Јавна соба, Radio Evropa e Lirë, Jasmina Jakimova, 9 qershor 2022

32 Ligji për koordinim të komunitetit të sigurisë dhe zbulimit, në dispozicion në: https://mvr.gov.mk/Upload/Documents/ZKBRZ%20108-19.pdf, botuar në Gazetën Zyrtare të RMV, nr.108, 28 maj 2019

33 Faqja zyrtare e Komitetit, në dispozicion në: https://nccvect.gov.mk/?q=mk/node/44

34 Studim mbi sigurinë informatike (dhe radikalizimin onlajn) në vendet e Ballkanit Perëndimor, në dispozicion në: https://www.rcc.int/download/docs/rcc-5c-20cyber-MAKEDONSKI%20WEB.pdf/79fd9ef650656b52fc8c7035d9b7e4bd.pdf , Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, 6 dhjetor 2018

35 Botuar në portalin Fakulteti.mk: "Si Facebook dhe Instagram na shndërrojnë në të varur", në dispozicion në: Како „Фејсбук" и „Инстаграм" нè претвораат во зависници B.B. Faktulteti.mk, 28 shkurt 2018

36 Botuar në Nezavisen Vesnik: "A ndikon Instagram në mendimet për vetëvrasje tek të rinjtë?", në dispozicion në: Инстаграм влијае на самоубиствени мисли на младите луѓе? - Независен Весник, Nezavisen, 17 shtator 2021

37 Artikull i The Guardian: "Ju desensibilizoheni ndaj asaj": Si mediat sociale ushqejnë frikën nga dhuna", në dispozicion në: 'You get desensitised to it': how social media fuels fear of violence | Social media | The Guardian, The Guardian, Robert Booth UK technology editor, 25 nëntor 2024

38 Botuar në The Guardian: "Dhuna në mediat sociale i bën adoleshentët të kenë frikë të dalin jashtë, zbulon studimi", në dispozicion në: Violence on social media making teenagers afraid to go out, study finds | Social media | The Guardian The Guardian, Robert Booth UK technology editor, 25 nëntor 2024

39 Artikull i The Times: "Djemtë bien pre e ndikimit toksik të manosferës", në dispozicion në: 'Boys falling prey to toxic influence of manosphere', The Times, 06 tetor 2024

40 Botuar në Fokus, në dispozicion në: https://fokus.mk/devojcheto-shto-pochina-vo-ilinden-se-kachilo-na-vagonot-da-snima-tik-tok-video/, Fokus, 26 shkurt 2023

41 Artikull i Vërtetmatësit: "Si funksionojnë mashtrimet e blerjeve në internet: Ata ju shesin produktin e gabuar, më pas ju bllokojnë", në dispozicion në: Како функционираат онлајн шопинг измамите: Ви продаваат погрешен производ, а потоа ве блокираат – Truthmeter, Vërtetmatës, 29 prill 2024

42 Publikimi i Qendrës Ndërkombëtare për Mbrojtjen dhe Sigurinë – Estoni, "Qëndrueshmëria kundër dezinformatave: Një mënyrë e re baltike për t'u ndjekur?", në dispozicion në: Resilience Against Disinformation: A New Baltic Way to Follow? - ICDS Dmitri Teperik, Solvita Denisa-Liepniece, Dalia Bankauskaitė, Kaarel Kullamaa, 20 tetor 2022

43 Studimi i Parlamentit Evropian: Harta e lajmeve të rreme dhe dezinformatave në Ballkanin Perëndimor dhe identifikimi i mënyrave për t'i luftuar ato në mënyrë efektive", në dispozicion në: Mapping Fake News and Disinformation in the Western Balkans and Identifying Ways to Effectively Counter Them | Think Tank | European Parliament, Samuel GREENE, Gregory ASMOLOV, Adam FAGAN, Ofer FRIDMAN, Borjan GJUZELOV, 23 shkurt 2021

44 Analiza nga Qendra e Angazhimit Baltik për Luftimin e Çrregullimeve të Informacionit (BECID): "Historitë e trazuara i kanë bërë Baltët më elastikë ndaj propagandës, por ne nuk jemi magjikisht imun ndaj dezinformatave", në dispozicion në: Turbulent histories have made the Balts more resilient to propaganda but we are not magically immune to disinformation Maria Murumaa-Mengel, 22 shkurt 2023

45 Artikull i Associated Press: "Shqipëria do të mbyllë TikTok për një vit duke e fajësuar atë për nxitjen e dhunës mes fëmijëve", në dispozicion në: Albania to close TikTok for a year | AP News, LLAZAR SEMINI, 21 dhjetor 2024

46 Njoftim në faqen zyrtare të Guvernatorit të Kalifornisë Gavin Newsom, në dispozicion në: Governor Newsom signs legislation to limit the use of smartphones during school hours | Governor of California, 23 shtator 2024

47 Artikull i Associated Press: "Ligji i ri i Brazilit kufizon përdorimin e telefonave të mençur në shkollat fillore dhe të mesme", në dispozicion në: https://apnews.com/article/smartphones-brazil-restrictions-children-bab6fd0ac6a277441bbaab235f9bbad2, MAURICIO SAVARESE dhe DIARLEI RODRIGUES, 14 janar 2025

48 Publikim i Texas Monthly: "Nëntëmbëdhjetë shtete kanë miratuar ligje në lidhje me celularët në shkolla. A është Teksas i radhës?", në dispozicion në:19 States Have Passed Laws Regarding Cellphones in Schools. Is Texas Next?, Texas Monthly, shkurt 2025

49 Artikull i France24: "Australia kalon ndalimin e parë në botë të mediave sociale për moshat nën 16 vjeç", në dispozicion në: Australia passes world›s first social media ban for under-16s NEWS WIRES, 28 nëntor 2024

50 Artikull i Wired.com: "MB konsideron ndalime të reja të telefonave të mençur për fëmijë", në dispozicion në: UK Considers New Smartphone Bans for Children | WIRED, Matt Reynolds 22 tetor 2024

51 Artikull i Radio Evropa e Lirë/Radio Liberty: "Pavel Durov, themeluesi i Telegram, i arrestuar në Francë, thonë zyrtarët", në dispozicion në: Павел Дуров, основачот на Телеграм е уапсен во Франција, велат официјални лица, Радио Слободна Европа, 25 gusht 2024

52 Artikull i The Guardian: "Pavel Durov i Telegramit njofton një goditje të re ndaj përmbajtjeve jolegale pas arrestimit", në dispozicion në: Telegram's Pavel Durov announces new crackdown on illegal content after arrest | Telegram | The Guardian, The Gurdian, 24 shtator 2024

53 Artikulli i Guardian: "Ekstremistët e të djathtës së skajshme ikin nga Telegram në SimpleX për shkak të veçorive të privatësisë", në dispozicion në: Far-right extremists flee from Telegram to SimpleX over privacy features | Technology | The Guardian, Ben Makuch, 4 tetor 2024

54 Hulumtimi i IFES: "Anulimi i zgjedhjeve në Rumani 2024: Adresimi i kërcënimeve të reja ndaj integritetit zgjedhor", në dispozicion në: The Romanian 2024 Election Annulment: Addressing Emerging Threats to Electoral Integrity | IFES - The International Foundation for Electoral Systems, Richard Nash, 20 dhjetor 2024

55 Artikull i Politico: "Ndikuesit e TikTok ikin nga Rumania mes hetimeve tatimore për rolin e tyre në zgjedhje", në dispozicion në: TikTok influencers flee Romania amid tax probe into their election role – POLITICO Andrei Popoviciu, 13 dhjetor 2024

56 Njoftim në faqen zyrtare të Komisionit Evropian, në dispozicion në: Commission opens formal proceedings against TikTok under DSA од 17 dhjetor 2024

57 Artikull i TVP: "Meta heq profilet e rreme në Moldavi para zgjedhjeve presidenciale", në dispozicion në: Meta takes down fake profiles in Moldova prior to presidential election,12 tetor 2024

58 Njoftimi zyrtar në ueb faqen e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në: https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/strategii/nacionalna_strategija_za_bezbednost_na_republika_severna_makedonija_1.docx_2.pdf, maj 2024

59 Komunikatë zyrtare e NATO-s, në dispozicion: NATO - Official text: Washington Summit Declaration issued by NATO Heads of State and Government (2024), 10-Jul.-2024, 10 qershor 2024

60 Faqja zyrtare e NATO-s: Appendix2.pdf

61 Studim nga Partnerët për Ndryshime Demokratike Serbi: "Drejt një zbatimi të realizueshëm të Aktit të Shërbimeve Digjitale në Ballkanin Perëndimor", në dispozicion në: dsa-wb-new-1.pdf Danche Danilovska-Bajdevska, Emily Wright, Maida Culahovic, Megi Reçi, Milica Tosic, Snezana Nikcevic and Teuta Sahatqija, Partners for Democratic Change Serbia, qershor 2024

62 Kumtesë e Fondacionit Metamorfosis, në dispozicion në: NISMA E FONDACIONIT METAMORPHOSIS PËR HARMONIZIM LEGJISLACIONIN ME LIGJIN PËR SHËRBIME DIGJITALE TË PËRFSHIRË NË PROGRAMIN E PUNËS SË QEVERISË PËR VITIN 2025 - Metamorphosis, 12 shkurt 2025

63 Publikimi: "Raporti i Kombeve të Bashkuara për zhvillimin botëror të ujit 2023" në dispozicion në: Governance: A 'whole-of-society' approach | United Nations iLibrary, Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, Mars 2023

64 Hulumtimi: Efekti i dezinformatave dhe ndikimeve të huaja në proceset demokratike në Maqedoninë e Veriut në vitin 2023, në dispozicion në: efektot-na-dezinformaciite-mk-10-1.pdf Fondacioni Metamorfozis, 2023

3. BALLAFAQIMI ME DEZINFORMATAT NË RRJETET SOCIALE: PSE ËSHTË I NEVOJSHËM VERIFIKIMI I FAKTEVE?

Shkruan: FILIP STOJANOVSKI

Verifikimi i fakteve është pjesë e domosdoshme e praktikës gazetareske profesionale, dhe duhet të jetë pjesë e procesit redaktues në çdo redaksi si aktivitet i brendshëm. Në pesëmbëdhjetë vitet e fundit, verifikimi i fakteve publike është shfaqur si një zhanër i veçantë gazetaresk, i cili përfshin publikimin e përmbajtjeve analitike gazetareske që analizojnë vërtetësinë e përmbajtjes me interes publik. Këtë lloj të verifikimit të fakteve e bëjnë edhe shërbime të specializuara, si Vërtetmatësi, i themeluar në vitin 2011 nga Fondacioni "Metamorfozis", e mund të jetë pjesë e punës së organizatave mediatike dhe analitike, qoftë përmes departamenteve të veçanta, qoftë si pjesë e produksionit të rregullt apo të kohëpaskohshëm.

Qëllimi kryesor i verifikimit të fakteve është të ndihmojë qytetarët të marrin vendime të informuara në sfera të ndryshme të jetës, të bazuara në informacione të verifikuara, të argumentuara mbi bazën e fakteve, të prezantuara publikisht dhe në një mënyrë që u mundëson lexuesve të kontrollojnë provat, për shembull duke cituar burimet.

Për t'iu përgjigjur pyetjes "kush i kontrollon kontrolluesit/verifikuesit", shërbimet e verifikimit të fakteve kanë zhvilluar një formë të veçantë të vetërregullimit gazetaresk, duke u organizuar në rrjete ku anëtarësimi varet nga përmbushja e standardeve të shkruara në kode, të cilat përfaqësojnë një formë të specializuar të kodit gazetaresk me detyrime për transparencë dhe llogaridhënie. Në kuadër të këtyre mekanizmave, kryhet certifikimi i rregullt – një lloj revizioni i respektimit të detyrimeve të kodit – në baza vjetore ose dyvjeçare. Kështu, Vërtetmatësi është një nënshkrues i certifikuar i kodit dhe i Rrjetit Ndërkombëtar të Verifikimit të Fakteve[1] (IFCN) dhe të kodit të sjelljes së Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve[2] (EFCSN).

Evoluimi i zhanrit filloi me verifikimin e vërtetësisë së deklaratave të politikanëve dhe përmbushjes së premtimeve, vërtetësisë së publikimeve në media dhe, së fundi, në rrjetet sociale.[3] Të gjitha ato përfshijnë identifikimin e përmbajtjeve të dyshimta, pavërtetësia e të cilave mund të shkaktojë dëm për shoqërinë, analizimin e tyre dhe publikimin e rezultateve. Në rastin e rrjeteve sociale, vetë platformat iniciojnë partneritete me verifikues faktesh të certifikuar (anëtarë aktivë dhe të verifikuar të njërit prej rrjeteve). Duke vepruar kështu, ata kanë mundësinë të fusin vlerësimet e vërtetësisë në softuerin e platformës, pas së cilës përdoruesit që i qasen përmbajtjes së vlerësuar kanë mundësinë të lexojnë se si është vlerësuar ajo dhe të klikojnë në një lidhje (vegëz) që shpie deri te recensioni publik që shpjegon vlerësimin.

Cilat janë sfidat kryesore në ballafaqimin me dezinformatat në rrjetet sociale në botë dhe te ne?

Një faktor kyç për zbatimin e verifikimit të fakteve në rrjetet sociale është gatishmëria e kompanive që zotërojnë platformat për të inkuadruar mekanizma për mbrojtjen e përdoruesve nga kërcënime të ndryshme, duke përfshirë edhe dezinformatat. Përvoja tregon se platformat e mëdha po u përgjigjen kërkesave për harmonizim me kornizat ligjore në ekonomitë më të mëdha të botës, si Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. Prandaj, për vendet më të vogla, anëtarësimi në BE është jashtëzakonisht i rëndësishëm, e madje edhe me statusin e kandidatit, përmes vetë harmonizimit të legjislacionit tonë, ne bëhemi kompatibil me atë sistem, gjë që sjell përfitime të niveleve më të larta të mbrojtjes të arritura kolektivisht.

Kështu, pas vitit 2018, disa platforma iniciuan programe partneriteti me verifikues faktesh si një mënyrë për t'u pajtuar me Kodin e Praktikave për Dezinformatat të BE-së[4], (i cili u shndërrua në një Kod sjelljeje sipas dispozitave të Aktit për Shërbimet Digjitale) sipas të cilit ata kanë detyrime për të moderuar përmbajtjet e dëmshme, të cilat përfshijnë jo vetëm dezinformatat, por edhe detyrim për mënjanimin e përmbajtjeve kriminale si gjuha e urrejtjes dhe nxitja e dhunës (të cilat janë edhe vepra penale sipas sistemit tonë ligjor). Në Shtetet e Bashkuara, ku nuk ka një kornizë të tillë ligjore, disa platforma kanë ndërmarrë hapa për të shënjuar dezinformatat gjatë pandemisë KOVID-19, duke vërejtur dëmshmërinë e tyre për shëndetin e njerëzve.

Vetë struktura e algoritmeve, të cilat preferojnë të promovojnë përmbajtje sensacionale që i keqpërdorin reagimet emocionale për të tërhequr vëmendjen dhe për të nxitur qëndrim dhe aktivitet më të gjatë në platformë, në vend se t'u mundësojnë përdoruesve të tyre që të kenë qasje në përmbajtje të sakta dhe të verifikuara, është sfida themelore në ballafaqimin me dezinformatat në rrjetet sociale. Prandaj, (mos) gatishmëria e platformave për të bashkëpunuar me verifikuesit e fakteve është një faktor kyç.

Aktualisht në vendin tonë është aktiv programi i partneritetit për verifikimin e fakteve i Meta-s, kompanisë pronare e Facebook-ut, Instagram-it dhe Threads. Një program i ngjashëm në TikTok po zbatohet në disa vende evropiane. Mirëpo, shumë platforma që përdoren nga bashkëqytetarët tanë nuk janë të interesuara për të inkuadruar një mekanizëm të tillë, duke i lënë ata në mëshirën e dezinformatave dhe mashtruesve të tjerë.

Në mungesë të mekanizmave të transparencës dhe llogaridhënies në rrjetet sociale, qytetarët nuk kanë se si të përcaktojnë nëse diçka është dezinformatë dhe nëse burimet janë të besueshme, nëse faqet dhe profilet që paraqiten si media apo personalitete janë autentike apo janë operacione mashtruesish. Konfuzioni lind edhe kur politikanët dhe influencuesit e tjerë postojnë opinione personale në profilet e tyre që më pas konsiderohen si pozicion i institucioneve, gjë që e vështirëson procesin e verifikimit të fakteve.

Një sfidë e dytë e madhe është ndërgjegjësimi i qytetarëve, pra ndryshimi në të kuptuarit e natyrës dhe funksionit të platformave kryesore të mediave sociale. Shumë njerëz i perceptojnë si hapësira publike, por në fakt janë hapësira private në pronësi të kompanive që vendosin rregullat e sjelljes, rregulla me të cilat përdoruesit e tyre duhet të bien dakord. Duke klikuar butonin unë pajtohem ("I Agree") në marrëveshjen për përdorim, çdo përdorues i rrjeteve sociale merr përsipër të respektojë rregullat e tyre dhe jep pajtimin se do t'i pranojë sanksionet e vendosura nga platforma.

Mungesa e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë për rolin e verifikuesve të fakteve e veçanërisht për kufizimet e metodologjive të tyre, krahasuar me funksionet e tjera të moderimit në rrjetet sociale, është rezultat i përpjekjeve të pamjaftueshme të platformave për t'i shpjeguar ato në detaje për përdoruesit e tyre, gjë që lë hapësirë për konfuzion dhe abuzim për shpifje.

Zakonisht, verifikuesit e fakteve nuk kanë mundësi për të mënjanuar përmbajtjet që i e kanë vlerësuar si dezinformata. Ato publikime mbeten të qasshme për publikun. Ka pasur raste kur postime të tilla janë mënjanuar nga platformat në baza tjera, gjegjësisht për shkelje të rregullave të tyre të sjelljes, si ndalimi i spam-it, shpërndarja e pornografisë, shkelje e të drejtave të autorësisë, dyshimi për lloje të tjera krimesh si promovimi i terrorizmit, gjuha e urrejtjes, kërcënime, nxitja e dhunës dhe onlajn maltretim. Ndërgjegjësimi i pamjaftueshëm i përdoruesve për mënyrën se si funksionojnë këto partneritete dhe çfarë mund të bëjnë dhe çfarë nuk mund të bëjnë verifikuesit e fakteve është një sfidë e përgjithshme gjatë ballafaqimit me dezinformatat në rrjetet sociale.

Presionet dhe sulmet nga rrjetet dezinformuese dhe influencuesit që përdorin dezinformatat janë gjithashtu një sfidë e madhe. Ato drejtohen jo vetëm ndaj verifikuesve të fakteve, por gjithashtu shërbejnë në mënyrë indirekte si një formë shantazhi kundër të gjithë përdoruesve të tjerë të mediave sociale. Nëpërmjet "gjuetisë së shtrigave" të kohëpaskohshme, ata përdorin verifikuesit e fakteve si "kurbane" për të frikësuar të gjithë të tjerët - shikoni se çfarë do t'ju ndodhë nëse prekni në gjëra që janë shpallur si politikisht të papërshtatshme.

Në përgjithësi, niveli i ulët i besimit në gazetarinë profesionale është një nga sfidat më të mëdha, pasi verifikimi i fakteve është në thelb një zhanër i specializuar gazetaresk. Nëse njerëzit nuk i besojnë demokracisë dhe institucioneve demokratike si gazetaria, nuk do t'u interesojnë as rezultatet konkrete. Në vendin tonë kjo lidhet me politizimin dhe tifozërinë partiake përkundër mendimit kritik. Kjo është një sfidë, sepse qytetarët që kanë mundësi të lexojnë verifikimet e fakteve shpesh nuk interesohen për faktet dhe argumentet, por vallë përmbajtja e caktuar korrespondon me pikëpamjet e tyre paraprake ose me përcaktimet ideologjike.

Çfarë roli luajnë organizatat që verifikojnë faktet në ballafaqimin me këto dezinformata? Cilat janë përfitimet kryesore për qytetarët/publikun nga kjo punë?

Përfitimi kryesor nga verifikimi i fakteve është se i jep të vërtetës një shans dhe i bën faktet të arritshme për të gjithë. Puna e verifikuesve të fakteve është publike dhe secili qëndrim i tyre duhet të jetë i dokumentuar mirë, duke krijuar gradualisht një regjistrim publik (ang. public record) që ka vlerë historike dhe zbatueshmëri afatgjatë si material edukativ.

Nga ky aktivitet përfitojnë drejtpërdrejt viktimat e mundshme të mashtrimeve, si dhe të gjithë individët dhe kompanitë për të cilët përhapen dezinformata, të gjithë ata, figurat dhe brendet e të cilëve keqpërdoren për të tërhequr klikime.

Disa dezinformata përsëriten vazhdimisht, ndonjëherë në valë si pjesë e fushatave, ose riciklohen në raste të ngjashme me ato kanë qenë të publikuara fillimisht. Arkivat e shërbimeve të verifikimit të fakteve veprojnë si një mburojë kundër dezinformatave të

tilla në rrjetet sociale, pasi që një ekspozim veçmë i publikuar mund të lidhet me një shpjegim tashmë të publikuar. Këmbëngulësia e gazetarëve është një përfitim i madh, sepse i jep publikut një shans që të mësojë faktet dhe të rishqyrtojë qëndrime dhe paragjykime të caktuara të pasakta që janë të rrënjosura thellë.

Fakti që rrjetet sociale nuk mënjanojnë postimet e shënjuara si dezinformata, por përkundrazi përmbajtjet e rreme mbeten të qasshme për t'u parë nga të gjithë, së bashku me informacionin se janë të rreme dhe një lidhje që shpie deri te shpjegimi se pse janë vlerësuar në atë mënyrë, u mundëson njerëzve që i kanë postuar ose shpërndarë të zbulojnë të vërtetën.

Është gjithashtu e rëndësishme të dihet se çfarë nuk bëjnë verifikuesit e fakteve. Ata nuk janë censurues dhe as nuk mund të kenë një rol të tillë, sepse partneritetet me vetë platformat nuk përfshijnë mundësinë për ta që të mënjanojnë përmbajtjet. Platformat që heqin përmbajtjet e bëjnë këtë përmes mekanizmave tjerë. Fatkeqësisht, në Shtetet e Bashkuara dhe në vende të tjera, përfshirë këtu edhe vendin tonë, nga qarqe politike populiste bëhen akuza të pabaza për censurë prej vitesh.

Është gjithashtu e rëndësishme të merren parasysh pritshmëritë joreale që verifikuesit e fakteve do ta zgjidhin vetë problemin e dezinformatave. Siç bën me dije Angie Drobnick Hollan, drejtore e Rrjetit Ndërkombëtar të Verifikimit të Fakteve (IFCN), një nga sfidat për verifikuesit e fakteve janë edhe kritikat se, si llojet e tjera të gazetarisë së pavarur të bazuar në fakte, kjo nuk ka asnjë efekt. Ajo thekson se kjo funksionon, por ndryshe nga ajo që supozojnë kritikët e saj:

> "Ja se cilat janë mënyrat në të cilat nuk funksionon verifikimi i fakteve: Verifikimi i fakteve nuk mund të parandalojë politikanët individualë që të fitojnë ose humbasin zgjedhjet. Nuk troket në dyert e votuesve dhe nuk mund t'i detyrojë ata të dalin për të votuar. Nuk u duket bindës njerëzve që votojnë bazuar në vlerat e tyre kulturore apo faktorët ekonomikë. Nuk e bën punën që duhet ta bëjnë partitë opozitare apo lëvizjet politike.
>
> Ajo që e bën në të vërtetë verifikimi i fakteve, dhe e bën mirë, është rezistenca ndaj narrativave të rreme dhe pengimi i tyre që të zënë rrënjë. Ai është në vijën e parë të dokumentimit të materialit për historinë. Ndërton njohuri publike të bazuara në prova që mund të përballojnë presionet politike. Kjo është arsyeja pse politikanët që përpiqen të krijojnë realitetet e tyre luftojnë kaq ashpër kundër verifikimit të fakteve, dhe kjo është arsyeja pse ata detyrojnë kompanitë teknologjike dhe platformat e mediave sociale t'u ndihmojnë atyre", shkruan Drobnik Holan.[5]

Çfarë pasojash mund të kenë vendimet për ndërprerjen e bashkëpunimit të Meta (dhe platformave të tjera të mëdha) me verifikuesit e fakteve?

Pasoja kryesore e vendimeve për ndërprerjen e bashkëpunimit të Meta (dhe platformave të tjera të mëdha) me verifikuesit e fakteve është lënia e hapësirës për ekspozim më të madh të qytetarëve ndaj dezinformatave, duke u mundësuar përfituesve të ndryshëm të manipulojnë dhe t'u servojnë përdoruesve gënjeshtra, të cilat më pas mund të përhapen falë algoritmeve të platformave.

Si pjesë e bashkëpunimit të tyre me Facebook-un, organizatat që verifikojnë faktet zakonisht i japin prioritet informacionit të rremë viral, mashtrimeve të shpikura që nuk kanë bazë faktike (ang.: hoax) dhe pretendimeve të rreme që janë aktuale e që mund të përgënjeshtrohen, të cilat janë pjesë e tendencave në rritje dhe kanë implikime për shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve.[6]

Vendimet e Meta për ndërprerjen e bashkëpunimit nuk do të kenë asnjë ndikim në verifikimin e fakteve në lidhje me publikimet e politikanëve apo partive politike, sepse verifikimet e tilla nuk janë vlerësuar fare në kuadër të partneritetit, pasi që sipas rregullave janë përjashtuar që nga fillimi, njësoj si opinionet dhe pikëpamjet që nuk mund të verifikohen me metoda gazetareske.

Pasojat më të tmerrshme dhe të menjëhershme janë nga përhapja e dezinformatave shëndetësore, të cilat do të shkaktonin që disa njerëz të refuzojnë ose të vonojnë aplikimin e metodave mjekësore nga të cilat mund të varej jeta e tyre dhe e njerëzve të tyre të dashur. Kjo ka ndodhur gjatë gjithë pandemisë KOVID-19, veçanërisht pasi u bënë të disponueshme vaksinat. Vrulli që ka lëvizja anti-vaksinuese në rrjetet sociale përbën një rrezik të madh për shëndetin e të gjithëve, veçanërisht për shkak se "ngurrimi për vaksinim" po mundëson rikthimin e disa sëmundjeve që konsideroheshin të zhdukura, si në vendin tonë ashtu edhe në mbarë botën. Në vendin tonë, për shembull, kemi raste të foshnjave të pavaksinuara dhe fëmijëve të vegjël që vdesin nga kolla e keqe (pertussis), lija etj.

Gjithashtu, do të hapet hapësirë për përhapjen e dezinformatave që janë bazë për mashtrime të ndryshme, pasi që nuk do të ketë etiketime të postimeve të dyshimta që i çojnë përdoruesit të blejnë barna të rreme – të cilat mund të rrezikojnë edhe shëndetin e tyre, ose të shkojnë në ueb-faqe ku mund t'u vidhen të dhënat personale ose paratë e tyre.

Ekipi i Vërtetmatësit paralajmëron se numri i mashtrimeve të zbuluara në 12 muajt e fundit është rritur dhe një pjesë e madhe e tyre janë të natyrës ndërkombëtare. Bizneset vendase po sulmohen me njoftime për lotari të rreme, zbritje dhe të ngjashme, të cilat mashtrojnë përdoruesit për të dorëzuar informatat e tyre personale dhe paratë e tyre. Disa nga këto mashtrime janë rajonale, siç shihet edhe nga fakti se promovohen me reklama të drejtuara për audiencë nga vendet fqinje, gjë që mund të shihet nga seksioni i transparencës në faqet në Facebook që i publikojnë. Këtu përfshihen mashtrimet për barna të rreme, çaje dhe pilula për humbje peshe, të cilat promovohen përmes reklamave si këtu, ashtu edhe në Bullgari dhe anasjelltas, ose mashtrime me keqpërdorim të imazheve dhe gënjeshtra për gjoja vdekje të njerëzve të famshëm, nga politikanët e deri te figura të medias dhe influencues.

Ndërprerja e bashkëpunimit ndërmjet platformave dhe shërbimeve të verifikimit të fakteve është gjithashtu një çështje sigurie, pasi do të lejonte ndikim më të madh për transmetimin e propagandës nga regjimet e huaja jodemokratike, me synimin për të minuar demokracinë si këtu, ashtu edhe në mbarë botën. Në vendin tonë, për shembull, ka shumë dezinformata që përhapen nga Kremlini, transmetohen dhe përkthehen në rajon, të cilat më pas përhapen nga profilet në vend. Vëllimi i shtuar i dezinformatave, që rrit mosbesimin në institucionet e sistemit demokratik, rrit rrezikun e cenimit të integritetit të zgjedhjeve. Në disa raste, ato janë të ndërthurura me kryerjen e krimeve të mbuluara nga Kodi Penal, si nxitja e krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe mohimi i gjenocidit. Mund të pritet gjithashtu një rritje e dezinformatave që mund të çojnë në dhunë. Një shembull i kësaj janë dezinformatat që përhapen nga lëvizjet kundër barazisë gjinore, ku përfshihen edhe shpifjet ndaj anëtarëve të grupeve të margjinalizuara për krime të supozuara.[7]

Kush dhe pse po sulmon verifikuesit e fakteve me akuza të pasakta se po censurojnë përmbajtjet në rrjetet sociale?

Sulmet ndaj verifikuesve të fakteve ndodhin në disa nivele. Ato fillimisht përfaqësojnë sulme kundër organizatave, pastaj personalisht kundër punonjësve të atyre organizatave, duke përfshirë kërcënime ndaj sigurisë fizike të njerëzve dhe familjeve të tyre. Niveli i tretë është kontestimi i së drejtës për të verifikuar faktet në përgjithësi, si pjesë e narrativave për indoktrinim ideologjik.

Për shembull, një element i rëndësishëm i fushatës me gjuhë së urrejtjes që filloi në nëntor të vitit 2020, e cila përfshinte shpifje se stafi i Metamorfozis si organizatë që verifikon faktet gjoja ka fshirë përmbajtje patriotike dhe futbollistike nga Facebook, ishte publikimi i të dhënave personale të punonjësve, që nga emrat e tyre deri te kolazhet e fotove të tyre.[8] Pavarësisht se shumica e mediave që publikuan shpifjen origjinale tërhoqën artikujt e tyre dhe kërkuan falje, e ato që nuk e bënë u dënuan ligjërisht për shpifje, të njëjtat gënjeshtra dhe materiale vazhduan të përsëriten dhe ripublikohen nga dezinformues të ndryshëm në rrjetet sociale, duke përfshirë disa media onlajn.

Përveç përpjekjeve për të njollosur reputacionin dhe për të nxitur dhunën kundër verifikuesve të fakteve, këto sulme shpesh kanë një komponent ideologjik të kontestimit të vlerave thelbësore të gazetarisë profesionale, të përfshira edhe në Kodin e gazetarëve të Maqedonisë[9]:

> "Detyra themelore e gazetarëve është respektimi i së vërtetës dhe të drejtës së publikut për t'u informuar në përputhje me nenin 16 të Kushtetutës sonë."

Narrativat e tillë promovojnë populizmin si një qasje politike, sipas të cilit ajo që e imponojnë si "të vërtetë" qendra të caktuara të pushtetit është më e rëndësishme sesa e vërteta që mund të përcaktohet përmes metodave shkencore dhe gazetareske. Në një botë të tillë realitetesh të ndërtuara në mënyrë oruelliane, termi "lajm i rremë" përdoret për të nënkuptuar «atë që nuk u pëlqen ose me të cilën nuk pajtohen". E gjatë kësaj, mu ata që e konsiderojnë fuqinë për të përhapur gënjeshtra si vlerë dhe mjet më të madh për pasurim, përkundër ligjeve dhe rregullave të logjikës, janë ata që janë më të zëshmit në shpifjen ndaj organizatave dhe njerëzve për të cilët faktet janë të shenjta. Nga ana tjetër, të njëjtit shpesh luajnë rolin e viktimës.

Në radhë të parë, kemi politikanë apo figura publike që kanë bërë deklarata kundër verifikimit të fakteve, shpesh përmes postimeve në profilet dhe faqet e tyre në rrjetet sociale. Disa prej tyre janë zyrtarë, deklaratat apo premtimet e të cilëve janë verifikuar dhe në bazë të dëshmive të disponueshme është argumentuar vallë janë të sakta apo të realizuara. Shpesh, këta janë politikanë të rangut më të ulët, të cilët përpiqen të tërheqin vëmendjen dhe simpatinë me pretendime të rreme se u është bërë njëfarë e padrejte. Në disa raste bëhet fjalë edhe për politikanë që drejtojnë fshehurazi rrjete mediatike për të manipuluar publikun, të përbërë nga media të tyre, për të cilat nuk janë botuar pronarët apo redaktorët, dhjetëra profile anonime dhe false në rrjetet sociale, të cilat veprojnë në bashkëpunim me një numër më të madh faqesh dhe grupesh në Facebook.

Deklarata kundër verifikimit të fakteve janë bërë nga politikanët në të dy anët e spektrit politik, veçanërisht nga ata që promovojnë narrativa antiperëndimore përmes dezinformatave.[10]

Shembulli më ekstrem është partia "E Majta" (Levica), e cila në programin e saj zgjedhor për Zgjedhjet parlamentare 2024 ka një kapitull për rrjetet sociale, në të cilin avokon "ndalimin dhe kriminalizimin e të ashtuquajturit faktçekim në mediat sociale, për shembull, vërtetmatësve në Facebook..."[11]. Në aspektin ligjor, një ndalim i tillë do të përfaqësonte censurë, gjë që ndalohet nga neni 16 i Kushtetutës. Në kundërshtim me këto angazhime, e njëjta parti ishte nënshkruese[12] e Kodit të Sjelljes në Hapësirën Onlajn gjatë proceseve zgjedhore dhe referendumeve, i cili afirmon verifikimin e fakteve si një nga aktivitetet kyçe në procesin zgjedhor.[13]

Në sferën mediatike, manipulimet më të shumta në lidhje me verifikimin e fakteve vërehen në ato media, redaktorët e të cilave më së paku respektojnë standardet gazetareske. Shumë shpesh, mediat që kanë më shumë vendime për shkeljen e kodit gazetaresk nga Komisioni i ankesave të KEMM-së janë të njëjtat që nisin ose u bashkohen fushatave kundër verifikimit të fakteve. Për shkak se redaktorët e mediave të tilla e dinë se ata mund të mbahen përgjegjës në gjykatë për shpifje, gjuhë të urrejtjes dhe diskriminim, ose nxitje për dhunë, artikujt shpesh janë në një formë më të butë, të bazuar në citate nga burime të tjera ose të shkruara në një mënyrë që përcjellin mesazhe nxitëse në mënyrë indirekte.

E përbashkëta e dy grupeve të mëparshme, si dhe "influencuesve" të tjerë të ndryshëm në mediat sociale që nuk e identifikojnë veten si politikanë apo gazetarë, është se ata e konsiderojnë verifikimin e fakteve si një pengesë për përhapjen e ndikimit të tyre, të llogaritur përmes numrit të klikimeve në përmbajtjen e tyre ose shikimeve të postimeve të tyre, d.m.th. shtrirje (ang. *reach*). Prandaj sulmet nga aktorë të tillë, përveç sulmeve kundër reputacionit personal (lat. *ad hominem*), insistojnë në satanizimin apo talljen me vetë konceptin e verifikimit të fakteve, sepse sa më shumë njerëzit bëhen rezistent ndaj dezinformatave, aq më pak "klientë" do të klikojnë në postimet e tyre të sensacionale apo manipuluese.

Në sulme të tilla pothuajse asnjëherë nuk ka kontestim specifik për saktësinë e përmbajtjes së vlerësimeve, pavarësisht se në kuadër të metodologjive të verifikimit të fakteve ata kanë mundësinë të ofrojnë argumente, sipas të cilave mund të bëhet korrigjimi, si i recensioneve, ashtu edhe i vlerësimeve përfundimtare.

Në kuadër të partneritetit me Facebook, ekziston edhe mundësia e ndryshimit të vlerësimeve nga verifikuesit e fakteve, nëse media korrigjon përmbajtjen e artikullit të shënjuar, procedurë e përdorur shpesh nga mediat onlajn në vendin tonë. Megjithatë, media të tilla shpesh nuk janë transparente ndaj lexuesve të tyre dhe nuk njoftojnë se kanë bërë një korrigjim, duke i fshehur audiencës informacione të rëndësishme. Dhe, përderisa janë korrektë në komunikimin e tillë dypalësh, disa prej tyre më pas përhapin përsëri pretendime me të cilat akuzojnë verifikuesit e fakteve për censurë, edhe pse e dinë se kjo është e pavërtetë.

Në rrjetet sociale kemi edhe një ekosistem të tërë manipulatorësh dhe mashtruesish, të cilët përpiqen të arrijnë sa më shumë "myshterinj" duke përhapur dezinformata nga fusha të ndryshme, duke besuar se ata që bien pas një lloj manipulimi janë të prirë të mashtrohen në mënyra të tjera. Për shembull, kemi mjekë të rrejshëm, shërues apo praktikues të ndryshëm të praktikave magjike, si parashikim të fatit, horoskop etj., të cilët publikojnë ose transmetojnë dezinformata në fushën e shëndetësisë, gjeopolitikës apo politikës në nivel kombëtar ose rajonal, shpesh të importuara nga vendet fqinje. Të gjithë ata më pas synojnë pjesën më naive ose të dëshpëruar të ndjekësve të tyre,

përmes postimeve publike dhe mesazheve private, duke u shitur atyre shërbime ose produkte, si barna të rreme, me të cilat nxjerrin shuma të konsiderueshme parash.

Struktura e fushatave për njollosjen e verifikuesve të fakteve po bëhet e parashikueshme, veçanërisht duke pasur parasysh se vitet e fundit kemi parë një përsëritje periodike të fushatave të tilla, zakonisht në fillim të vitit, si dhe në periudha para ngjarjeve të rëndësishme shoqërore. Zakonisht, si shkas për këtë shfrytëzohet postim i ndonjë dezinformuesi që pretendon se i është bërë padrejtësi, që më pas në atë postim të shtohen komentet, e nëse ai përshkallëzohet, pasojnë edhe artikuj në media.

Për shembull, në shkurt të vitit 2024, një fushatë e tillë përkoi me periudhën zgjedhore. Disa "influencues" vendas filluan të postojn, ndërsa fermat e trollëve dhe grupet në Facebook filluan të shpërndanin gënjeshtra për censurë nga verifikuesit e fakteve, duke u përpjekur të ushtronin presion përmes thirrjeve për dhunë. Postimet gjoja spontane pushuan si me komandë, pasi ambasadorët e BE-së dhe organizatat e mediave drejtuan apel publik ndaj institucioneve nacionale për të bërë hetim. Një sjellje e tillë ka ngritur dyshime për orkestrim nga ndonjë qendër e fuqisë, por rezultatet e hetimit nuk janë publikuar ende.

Këtë vit, një fushatë e ngjashme filloi më herët, në janar, e si shkas u përdor deklarata e Mark Zuckerberg për ndërprerje të programit të verifikimit të fakteve në SHBA, pas së cilës u deklarua në mënyrë manipuluese dështim i verifikimit të fakteve në mbarë botën.[14] Rrjeti Evropian i Verifikimit të Fakteve shpjegoi me atë rast se "barazimi i verifikimit të fakteve me censurën është një pretendim i rremë dhe keqdashës". Verifikuesit e fakteve nuk "censurojnë" askënd. Anëtarët tanë hetojnë dhe publikojnë prova të pretendimeve potencialisht të rreme. Gjithmonë ka qenë vendimi i Meta se çfarë të bëjë me etiketën e verifikimit të fakteve të përmbajtjes, jo i yni". EFCN kujtoi gjithashtu se deri pak kohë më parë, përpara se t'i nënshtrohej presionit politik, Meta e ka lavdëruar efikasitetin e sistemit të etiketimit, si nëpërmjet deklaratave, ashtu edhe përmes raporteve zyrtare të transparencës të dorëzuara në BE.[15]

"Ne e dimë se ky program funksionon dhe njerëzit shohin vlerë në shënjimet paralajmëruese që shfaqim në përmbajtje, pasi që partneri i verifikimit të fakteve e ka vlerësuar atë", thuhej në kumtesë në ueb-faqen e Meta për mënyrën se si funksionon programi.[16]

Çfarë duhet bërë për të përmirësuar luftën kundër dezinformatave në mediat sociale?

Gjendjet në rrjetet sociale pasqyrojnë gjendjet në shoqërinë në tërësi, dhe ato gjendje, nga ana tjetër, ndikojnë në gjendjet në fusha të tjera. Prandaj, për të përmirësuar qëndrueshmërinë ndaj dezinformatave, është e nevojshme një qasje sistematike, që përfshin të gjithë shoqërinë (ang. whole-of-society approach), me synim ndërtimin e një kulture të të menduarit kritik dhe dialogut social në të gjitha nivelet, duke filluar nga sistemi arsimor, marrëdhëniet midis institucioneve dhe palëve të interesuara në të gjithë sektorët, si dhe në nivel familjar dhe individual. Kjo qasje gjithëpërfshirëse u promovua në rekomandimet e 11 organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve akademike[17] që punojnë në çështjen e dezinformatave nga aspekte të ndryshme, të cilat në vitin 2023 filluan një nismë për ndërtimin e strategjisë nacionale për qëndrueshmëri ndaj ndikimeve të dëmshme të dezinformatave.[18]

Kjo nismë për strategji nacionale u pranua si pjesë e Planit vjetor të punës së Qeverisë për vitin 2024[1920], mirëpo procesi u ndal për shkak të zgjedhjeve. Në shtator të vitit 2024, ajo u ridorëzua[21] dhe mori një vlerësim të favorshëm nga Ministria e Drejtësisë[22]. Zbatimi i kësaj nisme sjell përfitime të rëndësishme për vendin në kuadër të procesit të integrimit evropian, pasi vendet kandidate për në BE janë të detyruara të zhvillojnë mekanizma për rezistencë ndaj dezinformatave në fushën e lirisë së shprehjes, dhe nga viti 2024 ky është kriter edhe në Kapitullin 31 negociues (politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes).[23] Është e rëndësishme të theksohet se iniciativa për një strategji kombëtare u vu në dukje si shembull i vetëm pozitiv nga Ballkani Perëndimor për aktivitet konkret në këtë fushë në kuadër të raporteve vjetore të Komisionit evropian.[24] Vetë procesi i ndërtimit të strategjisë duhet të përfshijë gjithashtu një analizë të ndikimit të rrjeteve sociale mbi pjesë të ndryshme të shoqërisë dhe përfshirjen e nevojave të qytetarëve në zgjidhjet e ardhshme ligjore që do të rezultojnë prej saj.

Në nivel shtetëror, një hap konkret urgjent është harmonizimi i kornizës ligjore të Maqedonisë së Veriut me Aktin e shërbimeve digjitale të BE-së.[25] (ang. Digital Services Act – DSA) dhe në veçanti zbatimi i drejtë i detyrimit për të përcaktuar "shënjues të besuar".[26] Kjo do ta bëjë vendin pjesë të një hapësire të përbashkët evropiane, të udhëhequr nga BE-ja, e cila mund të ndikojë kolektivisht në platformat kryesore dhe rrjetet sociale për të ofruar një nivel më të madh të mbrojtjes së përdoruesve, përfshirë edhe nga efektet e dëmshme të dezinformatave. Lidhur me këtë veçmë kemi përvojë pozitive me zbatimin e Rregullativës së përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave (ang. General Data Protection Regulation - GDPR) nga viti 2016, për shkak të së cilës platformat kanë përmirësuar rregullat e tyre në nivel global, dhe përfshirja e së cilës në Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale të Maqedonisë së Veriut u ka mundësuar institucioneve tona kompetente të mbrojnë në mënyrë më efektive privatësinë e qytetarëve, si brenda sistemit tonë ligjor, ashtu edhe në ndërveprim me kompanitë e huaja.

Të gjithë aktorët e tjerë socialë kanë mundësi të kontribuojnë në rritjen e qëndrueshmërisë ndaj dezinformatave në rrjetet sociale.

Këtu përfshihen kryesisht rrjetet sociale, të cilat duhet të nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi me verifikuesit e fakteve.

Institucionet shtetërore kanë një rol në edukimin e gjeneratave të reja, së bashku me prindërit dhe arsimtarët, gjë që kërkon zbatimin sa më të shpejtë të procesit të inkuadrimit të arsimimit mediatik dhe digjital në sistemin arsimor.

Media mund të kontribuojë shumë duke rritur bashkëpunimin me verifikuesit e fakteve, duke përdorur materialet dhe paralajmërimet e tyre për të ndihmuar audiencën e tyre që të mos mashtrohet.


Kompanitë e sektorit privat, të cilat shfrytëzojnë përfitimet nga verifikimet e fakteve që ekspozojnë mashtrimet me brendet e tyre, kanë gjithashtu mundësi të marrin një rol aktiv. Për shembull, përmes formave të mbështetjes për organizatat e shoqërisë civile që punojnë mbi ndërtimin e rezistencës - si pjesë e përgjegjësisë së tyre sociale, e gjithashtu si reklamues - duke inkuadruar norma etike gjatë zgjedhjes së mediave të cilave u paguajnë për hapësirën reklamuese.

Dezinformatat i bëjnë dëm mbarë shoqërisë, dhe secili mund të jetë viktimë, por edhe të kontribuojë në uljen e ndikimit të tyre.

(Autori është drejtor i partneritetit dhe zhvillimit në Fondacionin Metamorfozis, përgjegjës për aktivitete për ndërtim të rezistencës ndaj dezinformatave, arsimim mediatik dhe digjital)

Referencat:

1 Kodi i parimeve të IFCSN. IFCSN
2 Kodi i standardeve. EFCSN.
3 Verifikimi i fakteve në rrjetet sociale. Rubrikë në Vertetmates.mk
4 Kodi i praktikës mbi dezinformatat i vitit 2022, Komisioni Evropian
5 Rasti i fakteve. Nieman Reports, Angie Drobnic Holan, 10 shkurt 2025
6 Përmbajtja që verifikuesit e fakteve i japin përparësi, Qendra e Transparencës Meta, Meta Transparency Center, 10 maj 2024
7 Artisti poston një foto të tij si fëmijë, lëvizjet anti-gjinore e raportojnë për pedofili, 360 shkallë, 20 shkurt 2025
8 Gjuha e urrejtjes kundër Metamorfozis mbetet e pandëshkuar: "T'i pushkatojmë apo t'i sjellim në shtëpi me kurora varrimi?", Meta.mk, 7 dhjetor 2020
9 Kodi i gazetarëve të Maqedonisë, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë – SHGM
10 E majta dhe e djathta në Maqedoninë e Veriut po përhapin "vëllazërisht" narrativa dezinformative anti-perëndimore, Vertetmates.mk, 9 janar 2025
11 Partitë vetëm shkurtimisht përmendën luftën kundër dezinformatave në platformat e tyre zgjedhore. Vertetmates.mk, Mirosllava Simonovska, 23 maj 2024.
12 Qasja në kod. izborenkodeksonline.mk, ASHMAA
13 Kodi i sjelljes në hapësirën e internetit gjatë proceseve zgjedhore dhe referendumeve, ASHMAA, Shtator 2023
14 Verifikimi i fakteve është efektiv në luftimin e dezinformatave dhe nuk është censurë, EFCSN/ Metamorphosis, 8 janar 2025
15 Rregullorja (BE) 2022/2065 Akti i shërbimeve digjitale, Raporti i transparencës për Facebook-un, Meta, 25 tetor 2024
16 Si funksionon programi i verifikimit të fakteve të palëve të treta të Meta-së, Meta, 1 qershor 2021 (aktualisht nuk është në dispozicion, lidhja të çon në kopjen e arkivuar në Archive.org)
17 Rekomandime për veprim të përbashkët për të ndërtuar rezistencën e shoqërisë ndaj ndikimeve të dëmshme të dezinformimit, Fondacioni Metamorfozis, Maj 2023
18 Nismë: Krijimi i një Strategjie kombëtare për ndërtimin e qëndrueshmërisë sociale ndaj ndikimeve të dëmshme të dezinformatave, Departamenti për bashkëpunim me organizatat joqeveritare në Sekretariatin e përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Fondacioni Metamorfozis, 20 shtator 2023
19 Njoftim nga Sekretariati i përgjithshëm. Departamenti për bashkëpunim me organizatat joqeveritare në Sekretariatin e përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Fondacioni Metamorfozis, 25 tetor 2023
20 Njoftim nga Ministria e Mbrojtjes. Departamenti për bashkëpunim me organizatat joqeveritare në Sekretariatin e përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, 23 tetor 2023
21 Projekt-nismë: Krijimi i një Strategjie kombëtare për ndërtimin e qëndrueshmërisë sociale ndaj ndikimeve të dëmshme të dezinformatave. Departamenti për bashkëpunim me organizatat joqeveritare në Sekretariatin e përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Fondacioni Metamorfozis, 20 shtator 2025
22 Njoftim nga Ministria e Drejtësisë, Departamenti për bashkëpunim me organizatat joqeveritare në Sekretariatin e përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, 15 tetor 2025
23 Narrativa dezinformative që nxisin euroskepticizmin në Ballkanin Perëndimor, Konferenca POINT, Dalio Sijah, 27 qershor 2024
24 Raporti i Maqedonisë së Veriut 2024, Komisioni Evropian, 30 tetor 2024
25 Drejt harmonizimit të kornizës ligjore të Maqedonisë së Veriut me Aktin e shërbimeve digjitale të BE-së, Fondacioni Metamorfozis, 2024
26 Roli i 'shënjuesve të besuar' në mbrojtjen kundër dezinformatave dhe përmbajtjeve të tjera të dëmshme në rrjetet sociale. Instituti për Media dhe Analitikë IMA, Snezhana Trpevska, 20 shkurt 2025


iM@